



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve dhe Komunikimit
Menaxhim dhe udhëheqje në arsim

**ROLI I MËSIMDHËNËSIT NË MOTIVIMIN E NXËNËSIT PËR
ARRITJET NË MËSIM NË SHKOLLAT FILLORE NË KOSOVË**

PUNIM DIPLOME

Mentori:

Prof. dr. Arafat Shabani

Kandidati:

Jetmira Pireva

Qershor, 2020

DEKLARATË E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: “Roli i mësimdhënësit në motivimin e nxënësit për arritjet në mësim në shkollat fillore në Kosovë”, është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Jetmira Pireva,
Qershor, 2020.

PËRMBLEDHJE

Të jesh mësimdhënës nuk do të thotë vetëm të shpjegosh. Mësimdhënësit e sotëm kryejnë disa role njëkohësisht. Ata luajnë rolin e një prindi të dytë, mbajnë qetësi në klasë, janë udhëheqës dhe janë model i nxënësve kur të rriten, etj.

Një nga beneficionet e të qenit mësimdhënës është modeli që ai përcjell te nxënësit, sepse nëse dikush nga këta të fundit, nuk e ka një bërthamë të qëndrueshme familjare, ai do të arrijë që të përfitojë pikërisht këtë model nga mësimdhënësi. Mësimdhënësit të cilët paraqesin imazhin e besimit dhe të arritjes, janë mu ata që do të ndihmojnë në përmbushjen e nevojës së një fëmije për një model të mirë pozitiv kur familja mund të mos e ofrojë një gjë të tillë.

Motivimi ndoshta është faktori më i rëndësishëm që edukatorët mund të synojnë me qëllim që të përmirësojnë performancën në mësim. Shumë prej teorive janë munduar të japin shpjegime rreth kësaj çështjeje, por asnjë teori si e vetme, në mënyrë adekuate, nuk e shpjegon të gjithë motivimin njerëzor. Fakti është se të gjitha qeniet njerëzore në përgjithësi dhe nxënësit në veçanti, janë krijesa komplekse me nevoja dhe dëshira komplekse. Prandaj, motivimi është një ndër faktorët kryesor që ndikon në mësim, duke e shtuar aktivitetin e nxënësve, interesimin dhe vullnetin e tyre. Kështu, jo rrallë herë thuhet se ‘mësimdhënësi i mirë i tërheq nxënësit sikurse magneti copëzat e atomit’.

Ky punim, për më tepër, shtjellon aspektin se pse një nxënës mund të jetë i pamotivuar, duke shpalosur një sërë arsyesh, si: ata (nxënësit) mund të mendojnë se nuk janë të interesuar për ndonjë lëndë, të gjejnë metodat joadekuate të një mësimdhënësi ose të shpërqendrohen nga ndikimet e jashtme. Mandej, mund të thuhet se një nxënës i pamotivuar, në të vërtetë, ka vështirësi në të mësuarit dhe ka nevojë për një kujdes dhe vëmendje të veçantë. Ndërkaq, një nxënës i motivuar, gjithnjë është një person më i lumtur, më energjik dhe sheh rezultatet pozitive në mendjen e tij.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e motivimit tek nxënësit, që cilësohet si një ndër faktorët kryesor të mësimdhënies, para së gjithash, duke e shtuar aktivitetin e nxënësve, interesimin dhe vullnetin e tyre, ky hulumtim paraqet një nxitje specifike sa i përket ndikimit të motivimit tek nxënësit.

Hulumtimi i zhvilluar në disa komuna të Republikës së Kosovës (Kamenicë, Gjilan, Prishtinë, Gjakovë, Fushë Kosovë dhe Pejë), nxjerr në pah rëndësinë që kanë përprojekjet

shkencore në sqarimin e efekteve të motivimit tek nxënësit. Rezultatet e këtij studimi, pritet t'i shërbejnë mësimitdhënësve, njësisë komunale të arsimit dhe MASHT-it, ngase në bazë të këtyre rezultateve vihet re roli dhe rëndësia e motivimit tek nxënësit, si dhe të kuptuarit e mënyrave të motivimit nga ana e mësimitdhënësve.

Fjalët kyçe: Mësimdhënësit, motivimi, nxënësit, sukcesi.

SUMMARY

Being a teacher doesn't just mean explaining. Today's teachers perform several roles simultaneously. They play the role of a second parent, keep calm in the classroom, are leaders, and are role models when they grow up, and so on.

One of the benefits of being a teacher is the model he passes on to students, because if one of the latter does not have a stable family nucleus, he will be able to benefit from this model from the teacher. Teachers who represent the image of trust and achievement are the ones who will help meet the need of a child for a good positive role model when the family may not offer such a thing.

Motivation is probably the most important factor that educators can aim at in order to improve learning performance. Many theories have tried to give explanations on this issue, but no single theory, adequately, explains all human motivation. The fact is that all human beings in general and students in particular, are complex creatures with complex needs and desires. Therefore, motivation is one of the main factors influencing learning, increasing students' activity, interest and willpower. Thus, it is not uncommon to find that 'a good teacher attracts students like a magnet to pieces of the atom.'

This paper, moreover, elaborates on why a student may be unmotivated, revealing a number of reasons, such as: they (students) may think they are not interested in a subject, find inappropriate methods of a teacher or be distracted by external influences. Then, it can be said that an unmotivated student, in fact, has learning difficulties and needs special care and attention. Meanwhile, a motivated student is always a happier, more energetic person and sees positive results in his mind.

Given the importance of motivation in students, which is considered one of the main factors of teaching, first of all, increasing the activity of students, their interest and will, this research presents a specific impetus in terms of the impact of motivation on students.

Research conducted in several municipalities of the Republic of Kosovo (Kamenica, Gjilan, Pristina, Gjakova, Fushë Kosovë and Peja), highlights the importance of scientific efforts in clarifying the effects of motivation on students. The results of this study are expected to serve the teachers, the municipal education unit and the MEST, because based on these results, the role and importance of motivation in students, as well as understanding the ways of motivation by

teachers are noticed.

Keywords: Teachers, motivation, students, success.

РЕЗИМЕ

Да се биде учител не значи само да објаснуваш. Денешните наставници извршуваат неколку улоги истовремено. Тие играат улога на втор родител, одржуваат смиреност во училницата, се лидери и се модели на улоги кога ќе пораснат и сл.

Една од придобивките да се биде учител е моделот што тој им го пренесува на студентите, затоа што ако еден од второто нема стабилно семејно јадро, тој ќе може да има корист од овој модел од наставникот. Наставниците кои претставуваат имиџ на доверба и достигнување се оние што ќе помогнат да се задоволи потребата на детето за добар позитивен модел, кога семејството можеби нема да понуди такво нешто.

Мотивацијата е веројатно најважниот фактор што едукаторите можат да го постигнат со цел да ги подобрат перформансите на учењето. Многу теории се обидоа да го објаснат ова прашање, но ниту една теорија, соодветно, не ја објаснува целата човечка мотивација. Факт е дека сите човечки суштества воопшто и особено студентите, се сложени суштества со комплексни потреби и желби. Затоа, мотивацијата е еден од главните фактори кои влијаат на учењето, ја зголемуваат активноста, интересот и волјата на учениците. Така, не е невообичаено да се открие дека „добар учител привлекува студенти како магнет на делови од атомот“.

Згора на тоа, овој труд објаснува зошто студентот може да биде немотивиран, откривајќи голем број причини, како што се: тие (студенти) може да мислат дека не се заинтересирани за некој предмет, да најдат несоодветни методи на наставник или да бидат оддалечени од надворешните влијанија. Потоа, може да се каже дека немотивиран студент, всушност, има тешкотии во учењето и има потреба од посебна грижа и внимание. Во меѓувреме, мотивиран студент е секогаш посреќна, поенергична личност и гледа позитивни резултати во неговиот ум.

Со оглед на важноста на мотивацијата кај студентите, што се смета за еден од главните фактори на наставата, пред сè, зголемување на активноста на учениците, нивниот интерес и волја, ова истражување претставува специфичен стимул во однос на влијанието на мотивацијата врз студенти.

Истражувањето спроведено во повеќе општини на Република Косово (Каменица, Илацин, Приштина, акаова, Фуше Косово и Пеја), ја истакнува важноста на научните напори за разјаснување на ефектите од мотивацијата врз студентите. Резултатите од оваа студија се очекува да им служат на наставниците, општинската единица за образование и МОН, бидејќи врз основа на овие резултати се забележува улогата и важноста на мотивацијата кај учениците, како и разбирањето на начините на мотивација од страна на наставниците.

Клучни зборови: Наставници, мотивација, студенти, успех

Falënderime

Me këtë punim shënohet përfundimi i studimeve Master të cilat arrita t`i përfundoj falë ndihmës së shumë personave e të cilët dëshiroj t`i falënderoj dhe t`u shprehi shumë mirënjohje.

E falënderoj në mënyrë të veçantë udhëheqësin e temës profesorin Dr. Arafat Shabani i cili me kontributin, mbështetjen dhe me profesionalizmin e tij e bëri më të lehtë realizimin e këtij punimi. Gjithashtu, falënderoj edhe profesorin Demush Bajrami dhe Hasan Jasharin të cilët më ofruan këshilla të ndryshme, ide e diskutime që ky punim diplome të jetë sa më i plotë.

Shumë mirënjohje kam edhe për mësuesin të cilët nuk hezituan të ndajnë informacionet e tyre me mua dhe falënderoj edhe pjesëmarrësit gjithashtu që u treguan të gatshëm për t`u përgjigjur në pyetësor. Faleminderit që më keni dhuruar pak nga koha juaj.

Në fund, por jo nga rëndësia, falënderimet e veçanta shkojnë për familjen time, të cilët ishin dhe janë motivi im më i madh, mbështetja ime më e madhe në secilin hap timin. Faleminderit që jeni gjithmonë aty për mua.

Këtë punim ua dedikoj ju.

Faleminderit shumë të gjithëve!

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE.....	XI
LISTA E FIGURAVE.....	XIII
I. HYRJA.....	1
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1.1. Puna e mësimeve me nxënësit.....	4
2.2. Kuptimi mbi të nxënësit	6
2.3. Motivimi dhe rëndësia e saj për të nxënësit.....	7
2.6. Strategjitë për rritjen e motivimit tek nxënësit.....	11
2.7. Mënyrat efektive për të nxënësit.....	14
2.8.4. Teoria kognitive sociale	19
III. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	22
3.1. Qëllimi i hulumtimit.....	22
3.2. Detyrat e hulumtimit	22
3.3. Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezave	23
3.4. Grupi reprezentativ.....	23
3.5. Metodatat, instrumentet dhe procedurat e hulumtimit	23
IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET	25
4.2 Të dhënat me pyetësor nga mësuesit.....	35
V. PËRFUNDIMI	52
VI. REKOMANDIMET	54
VII. LITERATURA.....	56

VIII. SHTOJCA 60

Shtojca A: Pyetësor për nxënës 60

8. Si ju nxit mësuesi që ju të mësoni më shumë? a. Me vlerësim me anë të notës b. Me vlerësime simbolike (dhënie e një çmimi, shpërblimi etj.) 61

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Modeli i motivimit ARCS.....	18
Tabela 2. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe shkollës.	25
Tabela 3. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe suksesit në shkollë.	26
Tabela 4. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe metodave të përdorur nga mësimdhënësit.	27
Tabela 5. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe motivimit të nxënësive për të frekuentuar shkollën.	28
Tabela 6. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe motivimit për të mësuar.	29
Tabela 7. Krahasimi i variablave të shkollës dhe mënyrave për të nxitur nxënësit për të mësuar.	30
Tabela 8. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe metodave apo teknikave që thjeshtojnë mësimin.	31
Tabela 9. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe inkurajimi nga ana e mësimdhënësive tek nxënësit me fjalë të ngrohta.	32
Tabela 10. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe vlerësimit nga ana e mësimdhënësive.	33
Tabela 11. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe bashkëveprimit me shokët e klasës.	33
Tabela 12. Krahasimi i strukturës gjinore dhe klima në klasë.	34
Tabela 13. Krahasimi i strukturës gjinore dhe stresit në klasë.	35
Tabela 14. Krahasimi i variablave të strukturës gjinore të mësimdhënësive dhe kushtet në shkollë.	36
Tabela 15. Krahasimi i variablave të strukturës gjinore dhe mjedisit brenda punës.	36
Tabela 16. Krahasimi i variablave të strukturës së gjinisë dhe mbështetjes nga ana e drejtorit. ..	37
Tabela 17. Krahasimi i variablave të strukturës së gjinisë dhe lavdërimit nga ana e drejtorit për punën e tyre.	38
Tabela 18. Krahasimi i variablave të strukturës së gjinisë dhe përdorimit të mënyrave të mësimdhënësive në klasë.	38
Tabela 19. Krahasimi i variablave të strukturës së gjinisë në raport me problemet e disiplinës në raport me nxënësit.	39
Tabela 20. Krahasimi i strukturës gjinore dhe vështirësitë në komunikim me nxënësit.	40
Tabela 21. Krahasimi i strukturës gjinore dhe motivimit të nxënësive.	40

Tabela 22. Krahasimi i strukturës gjinore dhe metodave që përdoren për të motivuar nxënësit..	41
Tabela 23. Krahasimi i variablave për përdorimin e shpërblime për nxënësit.	41
Tabela 24. Krahasimi i strukturës gjinore dhe bashkëpunimit me nxënësit për rregullimin e klasës.....	42
Tabela 25. Krahasimi i variablave të strukturës gjinore dhe efektit të përdorimit të lëvdatave. ..	42
Tabela 26. Krahasimi i variablave të strukturës gjinore dhe lojës në klasë të mësimdhënëseve..	44
Tabela 27. Krahasimi i variablave të strukturës gjinore dhe metodave për të nxitur nxënësit të jenë bashkëveprues.	44
Tabela 28. Krahasimi i variablave të strukturës gjinore dhe bashkëveprimit në grupe.....	45
Tabela 29. Rëndësia e teknikave të motivimit tek nxënësit.....	46
Tabela 30. Vërtetimi i hipotezës së parë.....	49
Tabela 31. Vërtetimi i hipotezës së dytë.....	50
Tabela 32. Vërtetimi i hipotezës së tretë.....	50

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Modeli i teorisë së pritshmërisë.....	20
---	----

I. HYRJA

Njëra ndër kërkesat thelbësore të mësimdhënies bashkëkohore është realizimi i një mësimdhënie atraktive me nxënësit në klasë, si parakusht për motivimin e duhur të nxënësve për mësim. Motivimi jo i mjaftueshëm i nxënësve nga mësimdhënësit, ndikon drejtpërdrejt në angazhimin e tyre, përkatësisht mos angazhimin e nxënësve për mësim, gjë që ndikon dukshëm në humbjen e interesimit të nxënësve për t'u angazhuar në procesin mësimor në klasë. (Fullan, 2001).

Praktika Profesionale për Drejtorët e Shkollave në Kosovë, numër 04/2012, datë 02.05.2012, ka këto dy standarde, të cilat lidhen me rolin e drejtorit në motivimin e nxënësve:

1. Udhëheqja dhe motivimi: Drejtori i shkollës nxit suksesin e shkollës dhe të nxënësve duke lehtësuar zhvillimin, artikullimin dhe zbatimin e vizionit të të nxënësve në mësim, i pasqyruar në vlerat, misionin dhe objektivat e përbashkëta të shkollës e po ashtu edhe në mësimdhënien në klasë.
2. Mësimdhënien dhe mësim nxënës cilësor: Drejtori i shkollës siguron qasje të vazhdueshme në mësimdhënien e të nxënësve cilësor për të gjithë nxënësit përmes zbatimit të një kulture shkollë që vlerëson e përkrah mundësinë të barabarta për mësim nxënës për nxënësit dhe zhvillimin profesional të stafit.

Roli i nxënësit në arsim është vendimtar dhe duhet të shkojë përtej pamjes tradicionale të nxënësit si klient, apo marrës i njohurive. Motivimi në klasë është një funksion i pesë komponentëve: nxënësi, mësuesi, përmbajtja, metoda ose procesi dhe mjedisi. Aspektet e këtyre pesë komponentëve mund të kontribuojnë në procesin e motivimit (Kaylene & Williams, 2016).

Motivimi definohet si: “Nxitja e njerëzve për arritjen e niveleve të larta të performancës dhe kalimin e pengesave për të ndryshuar”. Mbi rëndësinë e motivimit, hulumtimet kanë treguar se nxënësit me motivim të lartë të punës tregojnë angazhim më të madh për punën e tyre (Researchgate, 2011).

Motivimi i mësuesit është një element kyç në motivimin e nxënësve. Mësimdhënësit e pamodifikuar mund të dëmtojnë motivimin e nxënësit. Studimet e kryera në të kaluarën në lidhje me motivimin e nxënësve tregojnë se fëmijët hynë në klasën e parë me shumë motiv dhe ndjenjat e motivimit humben dalëngadalë deri në shkollën e mesme. Stresi, ndjenjat e vetë-efikasitetit dhe emocioneve janë tre lojtar jetësor të motivimit të mësuesit (Girmus, 2011).

Ndërsa motivimi i nxënësve mund të jetë një detyrë e vështirë, por ia vlen për shkak të shpërblimit që merr. Nxënësit e motivuar janë më të gatshëm të marrin pjesë në mësim dhe të mësojnë. Të mësosh në një klasë ku nxënësit janë të motivuar është kënaqësi si për nxënësit ashtu dhe për mësuesit. Disa nxënës janë të vetë motivuar, ndërsa të tjerët kanë nevojë për mësuese të mirë, të cilët të mësuarit e bëjnë argëtues dhe i frymëzojnë ata që të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Motivimi përfaqësohet nga forcat që veprojnë mbi ose brenda një personi dhe e detyrojnë atë të sillet në një mënyrë të caktuar, sepse njerëzit janë të ndryshëm dhe nuk mund të motivohen nga e njëjta gjë. Prandaj puna e mësuesit është të gjejë mënyra dhe teknika të ndryshme se si të nxitë motivimin e nxënësve duke qenë se edhe nxënësit janë të ndryshëm në të nxënit në mënyrë që të arrijnë rezultatet më të larta (Callahan,2019).

Disa nxënës janë të natyrshëm entuziastë për të mësuar, por shumë prej tyre kanë nevojë ose presin instruktorë për të frymëzuar, sfiduar dhe stimuluar ata. Pra, mësimi efektiv në klasë varet nga aftësia e mësuesit (Ericksen, 1978).

Motivimi mund të konceptohet edhe si një energji dhe shtytje për të mësuar, punuar në mënyrë efektive dhe për të arritur potencialin e duhur në shkollë, ndërsa angazhimi është sjellje që pason nga ajo energji dhe shtytje. Motivimi gjithashtu është referuar si shumëdimensional, pasi që motivimi mat veprimet impulsive dhe të qëllimshme, ka të bëjë me faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe vëzhgon shkaqet e sjelljes. Motivimi është një nga konceptet më të rëndësishme psikologjik në arsim. Shumë hulumtues kanë treguar se motivimi është i lidhur me rezultate të ndryshme arsimore, të tilla si kurioziteti, këmbëngulja, të mësuarit dhe performanca.

Përderisa ka një numër faktorë që ndikojnë në performancën shkollore, një nga faktorët më me ndikim është motivimi. Motivimi gjithashtu është referuar si një angazhim akademik, i cili referohet edhe si një indikator kognitiv, emocional dhe si indikator i sjelljes në investimet e nxënësve dhe përkushtimin në arsim (Ryan & Deci,2008).

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1. Roli i mësimit në shkollë

Mësuesi ka qenë dhe mbetet figura qendrore në shkollë. Për mësuesin ideal është folur që nga koha e Sokratit, Aristotelit dhe Pestalocit. Ky mësues që konsiderohet si mësues ideal është vëzhgues, eksplorues, njohës i shpirtit, lexues i mire, tregimtar i hollë, një njeri me horizont të gjerë që është gjithmonë një hap para të tjerëve çka është e nevojshme të përmbushë imazhin e çdo mësuesi, mbi të gjitha të jetë human (Baloglu, 2001).

Mësimit luajnë rol shumë të rëndësishëm në jetën e nxënësve. Përveç që i edukojnë nxënësit, ata kujdesen për atmosferën në klasë, ndërtojnë ambient të ngrohtë, i udhëzojnë dhe shtojnë përpara nxënësit, bëhen shembuj dhe gjithmonë janë të gatshëm të dëgjojnë për problemet apo shqetësimet që ata mund t'i kenë (Ministry of Education, 2018).

Mësuesi duhet të ketë role të shumta brenda dhe jashtë klasës. Përcaktimi i marrëdhënieve mësues nxënës është një çështje themelore në të cilën ndërthuren koncepte, norma e parimet kryesore të pedagogjisë, psikologjisë dhe didaktikës. Mësuesi dhe nxënësi janë dy bashkëpunëtorë të lidhur ngushtë me njëri tjetrin gjatë gjithë viteve të shkollimit, ku mësuesi është drejtues dhe nxënësi duke punuar nën drejtimin e mësuesit do të përvetësojë njohuri, shkathtësi dhe shprehje që do të përcaktojnë programet mësimore, përvetësim që varet nga puna e mësuesit dhe përkushtimi i nxënësit. Përmes punës së tij mësuesi duke krijuar një partneritet të suksesshëm ndërmjet shkollës, nxënësit dhe familjes bënë të mundur përgatitjen e nxënësve për sukses gjatë procesit mësimor, pavarësisht diversitetit kulturor të nxënësve, në mënyrë që të përfundojnë me rezultatet sa më të larta në studimet e tyre dhe për të kontribuar sa më pozitivisht në jetën e tij dhe në komunitet (Begdok & Dilek, 2000).

Mësuesi duhet të mbajë parasysh gjithmonë që një mësimit e mirë është e vlefshme për shoqërinë, mësimit efektive është kyçi i një edukimi të vërtetë, mësuesi duhet të dijë që nxënësit kanë nevojë për shumë zotësi dhe njohuri për të qenë të suksesshëm, por mbi të gjitha për nxitje nga ana e mësuesit dhe të ndihen të motivuar e të zot në botën që ndryshon me shpejtësi rreth dijes e vlerave qytetare (Daniels, 2010).

Mësuesi duhet të jetë ai që krijon qytetar të ditur dhe të ndërgjegjshëm të cilët janë të aftë të shohin botën në mënyrë kritike, të cilët marrin vendime të zgjuara për jetën e tyre dhe të të

tjerëve. Edukimi është mënyra më e mirë për të mbajtur gjallë bazat e demokracisë në shkollë, në jetë, në shoqëri dhe familje, ndaj të gjithë duhet të punojnë për të rritur një brez qytetarësh në botë ku të gjithë i mirëpresin (Harris, 2005).

Sipas, Musai Bardhyl (1999) ekzistojnë role të shumëfishta të mësuesit të cilat janë:

- Mësuesi si ekspert mësimor duhet të merr vendime të rëndësishme rreth materialeve dhe metodave të mësimdhënies. Këto vendime bazohen në një numër faktorësh, si aftësitë dhe nevojat e lëndës dhe të gjitha qëllimet që duhet të arrihen.
- Mësuesi motivues merr vendime që ndikojnë në motivimin e nxënësve. Metodatat e vlerësimit të përdorura nga mësuesit si p.sh, mund të motivojnë nxënësit të rritin përpjekjet për të maksimizuar nxënien, të rritin nivelin e përvetësimit të njohurive.
- Mësuesi menaxhues bën vëzhgimin e veprimtarive në klasë, organizimin e mësimeve, përgatitjen e detyrave me shkrim dhe testeve, vlerësimin e detyrave, ndihmën që u jepet nxënësve që e kërkojnë, konsultat me mësues të tjerë, takimet me prindërit etj.
- Mësuesi këshilltar duhet të jetë vëzhgues i ndjeshëm i sjelljes njerëzore. Në çdo klasë, janë nxënësit ata që sjellin problemet e tyre vetjake tek mësuesi. Mësuesi duhet të u interpretoj rezultatet e mësimit nxënësve dhe prindërve.
- Mësuesi model, në çdo veprim mësuesi duhet të jetë model për nxënësin e tij. Veprimtaritë e tij janë të shumta duke filluar që nga ato rutinë që janë lidhur me organizimin dhe përgatitjen deri të mësimdhënies, korrigjimi i detyrave, testeve.

2.1.1. Puna e mësimdhënësve me nxënësit

Të jesh mësues nuk do të thotë vetëm të shpjegosh, mësuesit e sotëm kryejnë disa role njëkohësisht. Mësuesit e shkollave fillore kanë një rol kyç në zhvillimin e nxënësve. Sipas disa studimeve të kryera vitet e para të shkollës fillore në një farë mënyrë përcaktojnë drejtimin që do të ndjekin nxënësit në të ardhmen. Sipas Fondacionit të Arsimit George Lucas, roli i një mësuesi sot është shumë më i ndryshëm nga ajo që ishte dikur. Detyrat e tyre është të këshillojë nxënësit, t'i ndihmojë ata të mësojnë se si të përdoren njohuritë e tyre dhe ta integrojnë atë në jetën e tyre, në mënyrë që ata të jenë anëtarë të vlefshëm të shoqërisë. Mësimdhënësit inkurajohen të përshkatan me secilin nxënës dhe të përpiqen t'i sfidojnë dhe t'i frymëzojnë ata për të mësuar

(Portali shkollor, 2015).

Por, disa nga rolet kryesore të mësimit janë të paraqitura në vijim, të cilat janë:

- **Japin njohuri:** Roli më i zakonshëm që një mësues luan në klasë është t'i jap njohuri nxënësve. Mësuesit u jepet një plan program nga Ministria e Arsimit që duhet të ndjekin gjatë gjithë vitit shkollor dhe që është në përputhje me udhëzimet e shtetit. Kjo kurrikulë ndiqet nga mësuesit në mënyrë që gjatë vitit të gjitha njohuritë përkatëse të shpërndahen ose përcillen te nxënësit. Mësuesia bëhet në shumë mënyra duke përfshirë: leksionet, aktivitetet e vogla grupore dhe mësimin praktik.
- **Të bëhen prind i tretë:** Mësuesi ka rol më shumë se thjesht të planifikoj dhe mbaj orën mësimore. Pasi mësuesi shpenzon aq shumë kohë me nxënësit e tyre, mund të thuhet që ata bëhen si një lloj prindi i tretë për ta. Ata mund të jenë shembull i vazhdueshëm pozitiv për fëmijët.
- **Krijojnë ambiente të ngrohtë:** Nxënësit shpesh imitojnë veprimet e mësuesve, p.sh nëse mësuesit përgatisin një ambient të ngrohtë dhe të lumtur, nxënësit kanë më shumë gjasa të jenë të lumtur. Nëse nxënësit e vërejnë që mësuesi është i zemëruar ata do të reagojnë negativisht, gjë e cila reflektohet në sjelljen e tyre dhe mund të paraqitet si pengesë. Për këtë arsye mësuesit kanë rol shumë të rëndësishëm kur bëhet fjalë për ambientin.
- **Bëhen shembull:** Edhe nëse mësuesit nuk e mendojnë vetën si shembull, ata me dashje ose pa dashje mund të bëhen. Kjo ndodh për arsye se nxënësit kalojnë shumë kohë me mësuesit e tyre dhe kjo mund të ketë efekt pozitiv ose negativ në varësi nga mësuesi. Mësuesit nuk janë vetëm për t'i mësuar fëmijët, por edhe për t'i dashur dhe kujdesur për ta. Ata zakonisht respektohen shumë nga komuniteti dhe për këtë arsye bëhen shembull për nxënësit dhe prindërit.
- **Udhëheqin nxënësit:** Udhëheqja dhe këshillimi është një rol që është marrë në mënyrë të natyrshme nga mësuesit, pavarësisht a është bërë me qëllim apo jo. T'i udhëheqësh fëmijët është një mënyrë që mësuesit motivojnë fëmijët të bëhen më të mirët që mundën. Gjithashtu duke ju dhënë hapësirë fëmijëve që të shprehën lirshëm, ata do të fitojnë vetëbesim dhe kjo ju ndihmon që të jenë të suksesshëm (Lanier, 1997).

2.2. Kuptimi mbi të nxënit

Të nxënit përfshin përvetësimin, modifikimin dhe përpunimin e njohurive, aftësive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe sjelljeve të caktuara. Njerëzit nxënë në forma e mënyra të ndryshme aftësitë njohëse, gjuhësore, motorike, teknike dhe sociale, të cilat iu mundësojnë atyre përfshirjen, bashkëveprimin dhe zhvillimin e tyre individual. Në fëmijëri individi nxë aftësinë për të shkruar, lexuar, njihet me rregullat e para drejtshkrimore e gramatike, njeh numrat dhe fiton aftësitë dhe shprehitë bazë matematike, ndërsa gradualisht me rritjen e moshës dhe viteve të shkollimit fiton njohuri më të thelluara rreth dijeve dhe aftësohen në kryerjen e veprimtarive në nivele më të ndërlikuara intelektuale dhe psikomotorë, si zgjidhja e problemeve, shkrimi i eseve, ngjarja e biçikletës apo makinës, puna në bashkëpunim me të tjerët në një projekt grupi, etj. (Prosser & Tringwell, 1999).

Shoqëria njerëzore është e interesuar për përvetësimin e dijeve dhe zotërimin e aftësive profesionale, pasi prej tyre përfitohen të mirat materiale e shpirtërore. Mirëpo, edhe pse në parim, njerëzit e pranojnë se të nxënit është i rëndësishëm për jetën e tyre, jo të gjithë ia arrijnë suksesit në zotërimin dhe përvetësimin e objektivave të dëshiruara. Ka njerëz që ia arrijnë më shpejt, ka të tjerë që nxënë më me vështirësi dhe kjo e vë individin në dilema midis arsyeve biologjike që lidhen me potencialin intelektual të tij dhe arsyeve mjedisore që lidhen me edukimin, marrëdhëniet dhe teknologjinë. Për më tepër nuk është vetëm individi i përfshirë në këto dilema, por edhe vetë studiuesit pozicionohen në këndvështrime dhe qëndrime kundërshtuese, pasi edhe ata i shikojnë në pamje dhe pozicione të ndryshme shkaqet, proceset dhe pasojat e të nxënit (Kingore, 1999).

Në një përfaqje tjetër në se të nxënit është edhe proces edhe rezultat si ndodh ai: si zgjim i energjive të brendshme mentale nën ndikimin e ngacmuesve të jashtëm mjedisore, apo si meritë e gjetjes së faktorëve optimalë të jashtëm dhe mjeshtërisë së përcjelljes dhe instalimit të standardeve që pasqyrojnë ndryshimet e pritshme. Siç shihet, kjo analizë na e bën kuptimin mbi të nxënit edhe më kompleks. Për këtë arsye e kemi të vështirë të gjejmë një përkufizim të përgjithshëm e të përbashkët për të nxënit që të pranohet prej të gjithë teoricienët, studiuesit dhe prakticienëve të edukimit (Shuell 1986).

2.3. Motivimi dhe rëndësia e saj për të nxënë

Fjala motivim do të thotë në latinisht “Movere”, me lëviz, nxit, shty. Në esencë, motivimi është art i cili i shtynë njerëzit të bëjnë veprime të caktuar për shkak të dëshirës së tyre apo për shkak se një gjë të tillë e shohim si benefit. Duke përdorur këtë rrënjë, ne mund të përcaktojmë motivimin si diçka që e drejton dhe orienton sjelljen dhe një qëllim. Një tjetër mënyrë për të shprehur këtë koncept është se motivimi është një mënyrë shumë reale, motivimi orienton të nxënëit, i vë nxënësit në drejtimin e duhur dhe i mban të angazhuar (Researchgate, 2002).

Motivimi mund të përshkruhet si një gjendje që aktivizon, drejton dhe mirëmban sjelljen. Motivimi përfshin qëllime dhe kërkon veprimtari. Qëllimet ofrojnë shtysën për drejtimin e veprimit, ndërsa veprimi nënkupton përpjekje, këmbëngulje në mënyrë që të mbajë një veprimtari për një periudhë të gjatë kohore.

Motivimi tek nxënësit përcaktohet nga dëshira e një nxënësit (siç reflektohet në qasjen, këmbënguljen dhe nivelin e interesit) në lidhje me lëndët akademike kur kompetenca e nxënësit gjykohet kundër një standardi të performancës ose përsosmërisë (McClelland, 1953).

Ndërsa, motivimi i nxënësve mund të jetë një detyrë e vështirë, shpërblimet janë më shumë sesa ia vlen. Nxënësit e motivuar janë më të entuziazmuar për të mësuar dhe marrë pjesë. E thënë thjesht: Mësimi i një klase plot me nxënës të motivuar është e këndshme për mësuesit dhe nxënësit. Disa nxënës janë të vetë motivuar, me një dashuri të natyrshme për të mësuar. Por edhe me nxënësit që nuk e kanë këtë lëvizje natyrore, një mësues i shkëlqyeshëm mund ta bëjë mësimin argëtim dhe t'i frymëzojë ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë (Teach, 2020).

Shoqata e Psikologëve Amerikanë (APA,1997), në botimin e saj, “Parimet në qendër me nxënësin”, përmbledh faktorët e brendshëm (nën kontrollin e nxënësve) dhe faktorët e mjedisit (kontekstualë), të cilët bashkëveprojnë me njëri tjetrin. Nga katërmbëdhjetë parimet, tri lidhen drejtpërdrejt me motivimin për të nxënë:

- **Parimi i parë:** Lidhet me ndikimet motivuese dhe emocionale të të nxënëit, të cilat shkaktohen nga gjendja emocionale, bindjet, interesat, qëllimet dhe shprehitë e të menduarit.
- **Parimi i dytë:** I referohet krijimtarisë së nxënësve, të menduarit e nivelit të lartë dhe kureshtjen e natyrshme, të cilat ndikojnë në motivimin e brendshëm, për të nxënë.

Motivimi i brendshëm, për të nxënë stimulohet nga detyrat e reja dhe të vështira, të

rëndësishme për interesat personale, të cilat sigurojnë zgjedhje personale dhe të kontrollit.

- **Parimi i tretë:** Ka të bëjë me ndikimin e motivimit gjatë përpjekjeve të nxënësve. Nëse praktika e orientuar nuk ka motivim, gatishmëria për të vazhduar përpjekjet nuk është e detyruar.

Këto tri parime tregojnë gamën e faktorëve që ndikojnë në nxitjen e motivimit për të nxënë. Ata përfshijnë të qenit nxënës, të shprehur nëpërmjet vlerave dhe qëndrimeve, përfshirjen e nxënësve në mësim, kuptimin e tyre të kontrollit dhe vetefikasitetit, si dhe vullnetin e nxënësve për të ushtruar përpjekje, në arritjen e qëllimit të të nxënësit. (Ginsberg & Wlodkowski, 2000).

2.4. Mësimdhënia dhe motivimi i nxënësit

Mësuesit pothuajse çdo ditë, përballen me sfida të reja, nga sigurimi që aktivitetet e klasës të arrijnë standardet e deri tek adaptimi i planeve të mësimdhënësve për t'ju përshtatur programit mësimor. Duket sikur çdo ditë është një aventurë dhe mësuesit duhet të përpiqen që të bëjnë shumë detyra në të njëjtën kohë. Në vazhden e gjithë këtyre aktiviteteve që ata kanë çdo ditë, mund të harrojnë të marrin në konsideratë perspektivën e ndonjë nxënësi. Por duhet që ata të rishikojnë rëndësinë e mbajtjes së një mjedisi pozitiv në mënyrë që nxënësit të ndihen më mirë. “Nëse marrëdhënia ndërmjet mësuesit dhe nxënësit është e mirë, atëherë do të kenë përfitime të dyja palët.” (Këshilla, 2019).

Mësuesit e kuptojnë se çelësi për zhbllokimin e potencialit të nxënësve është duke zhvilluar marrëdhënie pozitive dhe të respektueshme me nxënësit e tyre duke filluar në ditën e parë të vitit shkollor. Është thelbësore që mësuesit të fitojnë besimin e nxënësve në fillim të vitit. Një klasë e ndërtuar me besim dhe me respekt të ndërsjellë është një klasë e lulëzuar plot me mundësi aktive dhe të angazhimit të të nxënësit. Disa mësues janë më të natyrshëm në ndërtimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve pozitive me nxënësit e tyre sesa të tjerët. Nxënësit gjithmonë përgjigjen pozitivisht kur një mësues është entuziast dhe i pasionuar për mësimet që po mësojnë. Kur një mësues prezanton përmbajtje të re me entuziazëm, studentët do të marrin atë që duhet. Ata do të marrin po aq të ngazëllyer sa mësuesi. Nëse mësuesi është pozitiv, studentët në përgjithësi do të jenë pozitivë. Mësimi duhet të jetë argëtues dhe emocionues. Askush nuk dëshiron të kalojë kohë në një klasë ku ligjërimi dhe marrja e notave janë normat dhe nuk ka asnjë zhvillim tjetër.

Nxënësve u pëlqejnë mësimet krijuese, që kapin vëmendjen e tyre dhe u lejojnë atyre të marrin atë që duhet në procesin e të mësuarit. Marrëdhënia e mësimdhënësve është shumë e rëndësishme për nxënësit (Info Shqip, 2017).

Duke pasur këtë në mendje, mësuesit duhet të përqipen të mësojnë sa më shumë për nxënësit e tyre dhe të shtojnë sa më shumë informacion që të jetë e mundur për të ilustruar mësimin. Pra, nxënësit që ndiejnë një lidhje të fortë me mësimin janë më të predispozuar që t'i kushtojnë vëmendje dhe të marrin pjesë. Lëvdatat e drejtpërdrejta janë një mënyrë shumë efektive për t'i inkurajuar ata që të vazhdojnë me një sjellje të mirë si, pjesëmarrje aktive, qetësi kur punojnë në grup, si dhe sjelljen e shembujve të përshtatshëm për të nxitur diskutimin në klasë. Edhe një buzëqeshje e mësuesit mund të jetë shumë për të inkurajuar vetëbesimin dhe sjelljen e nxënësve (Keleg, 2010).

Inkurajimi i nxënësve do të ushqejë marrëdhënie të mira gjatë gjithë vitit shkollor. Ata duhet të konsiderojnë që të ruajnë hapësira të veçanta për të ekspozuar punët e nxënësve, si ese, projekte, apo kërkime duke treguar kështu cilësitë që mësuesve ju duken më të rëndësishme në një detyrë. Kur një mësues të vlerësojë punën e një nxënësi, ai duhet që së pari të monitorojë dhe identifikojë atë që nxënësi ka bërë mirë. Vetëm nisur nga kjo pikëpamje, ata mund të bëjnë sugjerime për përmirësime. Mësuesit duhet që të kuptojnë si dobësitë ashtu edhe prirjet e nxënësve të tyre me anë të reagimeve të tij të mirë planifikuara (Korkmaz, 2002).

2.5. Faktorët që ndikojnë në motivimin e nxënësve

Motivimi në arsim mund të ketë një ndikim dramatik në performancën dhe rezultatet e nxënësve. Prandaj, prindërit dhe mësuesit që janë të gatshëm t'i ndihmojnë fëmijët e tyre të bëjnë më të mirën në shkollë duhet të jenë të vetëdijshëm për faktorët që ndikojnë në motivimin e nxënësve. Motivim është gjendja që mund të ruajë vëmendjen dhe sjelljen e nxënësve, si dhe siguron më shumë energji të nevojshëm për të udhëhequr detyrat drejt përfundimit. Në arsim, motivimi mund të ketë një sërë efektesh në sjelljen, preferencat dhe rezultatet e nxënësve (Harandi, 2015).

Faktorët që ndikojnë në motivimin e nxënësve në arsim janë:

- **Struktura e klasës dhe kurikula:** Kur nxënësit kuptojnë ose shohin se klasat ndjekin një strukturë dhe kurikulë apo materialet e klasës janë përgatitur paraprakisht, u siguron atyre

një sens më të madhe të sigurisë. Ndjenja e sigurisë është një nga nevojat thelbësore për ata. Kur kjo sigurohet në një mjedis mësim, ai lejon nxënësit të përqendrohen plotësisht në materialin mësimor.

Për t'i ndihmuar nxënësve të ndjehen të sigurt, mësimdhënësit duhet të planifikojnë orë mësimore dhe kurikula. Të gjitha materialet që do të përdoren në klasë duhet të përgatiten paraprakisht.

- **Sjellja dhe personaliteti i mësuesit:** Nëse një nxënës ka një emocion negativ si frika ose nuk i pëlqen mësuesi i tij, kjo mund të ndikojë negativisht në qëndrimin e tij ndaj temës në tërësi. Nëse një mësimdhënës tregon një preferencë ndaj nxënësve të caktuar ose përdor gjuhë poshtëruese kjo mund të ulë motivimin e tyre në arsim. Nga ana tjetër, mirësia, optimizmi, reagimi pozitiv dhe inkurajimi mund të ndikojnë pozitivisht në motivimin e nxënësve për të mësuar.
- **Metoda e mësimdhënies:** Nxënësit kanë më shumë të ngjarë të mbajnë motivimin e tyre në arsim nëse mësimdhënësi përdor metoda të ndryshme mësimore. Kjo krijon larmi dhe parandalon që studentët të mërzhiten.
- **Zakonet dhe përfshirja e prindërve:** Shprehitë prindërore mund të ndikojnë në motivimin e fëmijëve, veçanërisht në motivimin e brendshëm. Kjo përfshin:
 - Duke pyet për ditën e tyre,
 - Duke dëgjuar në mënyrë aktive,
 - Duke ndihmuar me detyra ose aftësi specifike të mësuara në shkollë,
 - Duke marrë pjesë në mbledhjet e prindërve,
 - Duke inkurajuar fëmijët për të përfunduar detyrat e shtëpisë.

Një zakon tjetër që është vërtetuar se përmirëson motivimin, është lexim. Të lexuarit tek fëmijët e vegjël i ndihmon ata të zhvillojnë shkrimin më shpejt sesa të flasin. Sidoqoftë, niveli i të kuptuarit të leximit mund të përcaktoj suksesin e nxënësve në vitet e mëvonshme shkollore (Martin, 2001).

- **Çështjet familjare dhe paqëndrueshmëria:** Njësoj si mungesa e sigurisë në klasë, edhe mungesa e sigurisë në shtëpi mund të ndikojë negativisht në motivimin e arsimit. Fëmijët që jetojnë me të dy prindërit mesatarisht marrin nota më të mira se fëmijët që nuk jetojnë me të dy prindërit. Konfliktet familjare dhe përçarjet mund të rezultojnë në një performancë më të dobët akademike.

- **Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët:** Ndërsa fëmijët rriten, ndikimi që bashkëmoshatarët kanë mbi ta rritet gjithashtu. Prandaj, problemet dhe konfliktet me moshatarët mund t'i bëjë nxënësit të ndjehen më pak të sigurte për statusin e tyre shoqëror midis moshatarëve, të rrisin nivelin e stresit dhe motivimin më të ulët në arsim.
- **Mjedisi i të nxënit:** Mjedisi shkollor ose klima e shkollës është një tjetër faktor që ndikon në motivimin në edukim. Ambienti shkollor i referohet normave dhe rregulloreve të ndryshme që përcaktojnë klimën e përgjithshme në shkollë. Mjedisi pozitiv i shkollës i bën nxënësit të ndjehen të sigurt gjithashtu edhe plotësimi i nevojave të tyre themelore ndihmon në sigurimin e një mjedisi optimal për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme shoqërore. Shumë klasë dhe mjedisi i të mësuarit që është shumë serioz mund të ulë motivimin në arsim. Gjithashtu një element argëtues në klasë mund të ndihmojë për të lehtësuar atmosferën dhe për të përmirësuar motivimin dhe rezultatet. Lejimi i kohës të mjaftueshëm për të luajtur dhe pushimi gjithashtu mund të ketë një efekt pozitiv .
- **Vlerësimi:** Ndërsa vlerësimi i standardizuar rrit standardet e arritjes, ai mund të ndikojë negativisht në motivimin e nxënësve në edukim, veçanërisht për një nxënës në moshë më të re, është shumë e zakonshme që nxënësit të humbasin motivimin nëse testet vazhdimisht janë shumë sfiduese, kjo nuk ofron një kuptim të arritjes dhe ul motivimin në arsim me kalimin e kohës. Kështu është e rëndësishme që mësuesit të eksperimentojnë dhe të përdorin metoda të ndryshme të testimit, të cilat do të jenë në gjendje të adresojnë nevojat e ndryshme të mësimit të nxënësve (Silva, 2019).

2.6. Strategjitë për rritjen e motivimit tek nxënësit

Mësuesit shpenzojnë vite të tëra dhe shumë kohë për t'u bërë ekspertë në fushat e tyre të përmbajtjes, me grada dhe certifikime mësimor për ta promovuar atë. Por, një mësues i shkëlqyeshëm pranon se motivimi i studentëve është i nevojshëm për sukses në të nxënë dhe se mësuesit janë në pozitë të përsosur për të përmirësuar motivimin e nxënësve.

Më poshtë janë të paraqitura disa strategji që mund të përdoren në klasë për të ndihmuar në motivimin e nxënësve:

1. Promovimi i mentalitetit të rritjes gjatë mentalitetit fiks

Në librin e saj, *Mindset*, Carol Dweck argumenton se studentët kanë një besim themelor në lidhje me mësimin ose një mentalitet fiks ose një mentalitet rritjeje. Një besim fiks i mendimit sugjeron që njerëzit kanë lindur me ose pa aftësi dhe talent të caktuar, dhe se aftësitë nuk mund të ndryshohen. Nxënësit e fiksuar të mendimit përpiqen të dëshmojnë veten e tyre dhe shpesh do të largohen nga sfidat sepse nuk duan të duken se po luftojnë. Një nxënës i mentalitetit të rritjes, nga ana tjetër beson se aftësitë dhe talentet mund të kultivohen dhe përmirësohen përmes punës së palodhur. Nxënësit e mentalitetit të rritjes gëzojnë një sfidë dhe i shohin luftërat dhe dështimet si pjesë të nevojshme të rritjes. Nxënësit me një mentalitet rritjeje sigurisht që janë më të motivuar për të punuar shumë. Një nga elementët më të fuqishëm të feedback-ut për nxënësit tanë është t'i lavdërojmë ata për përpjekjet dhe punën e palodhur. Përgjatë një cikli mësimi, mësuesit vlerësojnë përparimin e nxënësve duke përfshirë vlerësime formuese dhe përmbledhëse. Qëllimi i vlerësimit formativ është të përcaktojë mësimin e nevojshëm për sukses përfundimtar në një vlerësim përmbledhës të mëvonshëm. Vlerësimi formativ informon mësuesit dhe nxënësit për nevojat e tyre dhe klasave për përmirësim në mënyrë që të dy mund të veprojnë në mënyrë të duhur për të përmirësuar performancën në vlerësimin përfundimtar (Dweck, 2008).

2. Zhvillimi i marrëdhënieve kuptimplotë dhe respektuese me nxënësit

Nëse do të frymëzojmë dhe motivojmë me të vërtetë të gjithë nxënësit, duhet të njohim secilin prej tyre në një nivel personal. Duhet të dimë interesat dhe hobi të tyre, me kë ata qëndrojnë, situatat e tyre familjare dhe çfarë i emocionon ata. Secili student do të kërkojë strategji të ndryshme motivuese dhe ne duhet t'i njohim ata që të jenë në gjendje të parashikojnë se cilat strategji mund të funksionojnë.

Kjo është një mundësi për ne të mësojmë rreth nxënësve tanë si dhe t'u bëjmë me dije se ne kujdesemi individualisht për ta. Të gjithë mësojmë ndryshe. Në secilën klasë ekzistojnë disa lloje të nxënësve: vizual, prekës, verbal dhe më të rezervuar. Ne mund ta shohim si përgjegjësinë tonë për ta zbuluar këtë duke i njohur ato dhe të përpiqemi t'i mësojmë ata në përputhje me rrethanat. Kjo punë rezulton në aftësinë tonë për të njohur nxënësit tanë, e cila çon në një bashkësi më të kohezuar dhe të hapur të mësimi.

3. Rritni një komunitet të nxënësve në klasën

Nxënësit kanë nevojë për një mjedis në klasë që është i sigurt, ku ata janë të gatshëm të marrin rreziqe dhe të luftojnë. Për të arritur këtë qëllim, nxënësit dhe mësuesit duhet të punojnë së bashku drejt qëllimeve të përbashkëta kolektive. Nxënësit duhet të jenë të gatshëm të punojnë gjithashtu edhe të ndihmojnë nxënësit e tjerë në klasë. Beteja duhet të jetë e pranueshme dhe e inkurajuar si pjesë e procesit mësimor.

Mësimdhënia tradicionale përbëhet nga mësuesit që ligjërojnë dhe nxënësit bëjnë shënime, të ndjekura nga nxënësit që bëjnë punë të pavarur për të kontrolluar mirëkuptimin. Shndërrimi i këtij modeli të vjetërsuar për të përfshirë më shumë kohë kur nxënësit po flasin me nxënësit sjell komunitetin e vërtetë. Puna në grup bashkëpunues duhet të jetë veprimtaria midis ligjëratorëve të mësuesve dhe punës së pavarur. Kjo është koha kur nxënësit mund të tretin informacionin dhe të bëjnë pyetje kolektive.

Puna e nxënësve duhet të shfaqet me krenari gjatë gjithë orës së mësimi. Kjo u dërgon një mesazh nxënësve se ata janë pjesëmarrës aktiv në krijimin e njohurive në klasë (Brophy, 2013)

4. Vendosja e pritshmërisë të lartë dhe vendosja e synimeve të qarta

Mbështetja e nxënësve ndërsa luftojnë u lejon nxënësve të ngrihen për t'i përmbushur ato pritshmëri. Kur pritjet janë transparente, nxënësit e dinë se ku drejtohet mësimi i tyre dhe janë të motivuar për të arritur atje sepse duket e mundur. Puna drejt qëllimeve ditore, javore dhe vjetore u jep nxënësve një qëllim dhe një kuptim për punën e palodhur që ata bëjnë. Qëllimet e mësimi të përditshëm duhet të jenë të dukshme, të postohen dhe referohen çdo ditë. Vendosja e “qëllimit të ditës” në fillim të mësimi u jep nxënësve një qëllim për mësimin e tyre. Nxënësit gjithashtu mund të vlerësojnë në mënyrë formale veten në fund të çdo mësimi duke kontrolluar për të qenë të sigurt se kanë përmbushur qëllimet e të nxënësve.

Mbajtja e pritjeve të larta për akademikët është e barabartë me të mësuarit, por standarde të larta për sjellje, gjuhë akademike, punë në grup, dhe madje edhe gjatësia dhe formati i punës individuale është gjithashtu e nevojshme për mësimin e thellë.

5. Mësues inspiruese

Shumica e të rriturve mund të kujtojnë një mësues specifik nga fëmijëria e tyre që pati një ndikim të qëndrueshëm. Këta janë mësuesit që kanë frymëzuar, sfiduar dhe motivuar

nxënësit aq sa duhet të jenë të paharrueshëm vite më vonë. Mësuesit inspirues paraqesin sukses për nxënësit e tyre (National Board, 2018).

2.7. Mënyrat efektive për t`i nxitur nxënësit

Motivimi i nxënësve është një proces i vështirë, pavarësisht moshës që mund të jenë ata. Kur nxënësit duan të përfundojnë punën e tyre dhe duan të kenë suksese gjërat do të shkojnë mirë në klasë dhe ata do të mësojnë dhe do të kenë një ditë të dobishme në shkollë.

Mirëpo, meqenëse motivimi i mësuesit është shumë thelbësorë në nxitjen e mësuesit për të dhënë mësim dhe për të përcaktuar dijet në mënyrë efektive, mënyrat që ndikon motivimi i mësuesit në arritjet akademike të nxënësve janë:

- **Inkurajimi i nxënësve:** Nxënësit i shikojnë mësuesit për miratim dhe përforcim pozitiv dhe kanë më shumë gjasa të jenë entuziastë për të mësuar nëse ata ndjejnë se puna e tyre është e njohur dhe vlerësuar. Mësimdhënësit duhet të inkurajoni komunikimin e hapur dhe të menduarit e lirë me nxënësit e tyre për t`i bërë ata të ndjehen të rëndësishme. Pra duhet të jenë entuziastë. Lëvdoni shpesh nxënësit tuaj. Njihuni për kontributin e tyre. Nëse klasa juaj është një vend miqësor ku nxënësit ndihen të dëgjuar dhe të respektuar, ata do të jenë më të etur për të mësuar (Aaronson & William, 2007).
- **Përfshirja e nxënësve:** Një mënyrë për të inkurajuar nxënësit dhe për t`u mësuar atyre përgjegjësinë është që t`i përfshijë në klasë. Të bëhet argëtim pjesëmarrës duke i dhënë secilit nxënës një punë për të bërë. Jepni nxënësve përgjegjësinë për të ngritur ose dekoruar klasën. Cakto një nxënës që të fshijë dërrasën e zezë ose të nxjerrë materialet. Bëni nxënësit të punojnë në grupe dhe t`i caktojnë çdo detyrë ose rol. Dhënia e nxënësve një ndjenjë pronësie u lejon atyre të ndihen të përmbushur dhe inkurajojnë pjesëmarrjen aktive në klasë.
- **Oferta e stimujve:** Përcaktimi i pritjeve dhe marrja e kërkesave të arsyeshme inkurajon nxënësit të marrin pjesë, por nganjëherë nxënësit kanë nevojë për një shtytje shtesë në drejtimin e duhur. Ofrimi i nxënësve nxitje të vogla e bën të mësuarit argëtim dhe i motivon nxënësit të shtyjnë veten. Stimujt mund të shkojnë nga të vogla në të mëdha duke i dhënë një privilegj të veçantë një studenti shembullor, në një parti pica klasës nëse

rezultati mesatar i testit rritet. Shpërblimet u japin nxënësve një ndjenjë arritjesh dhe i inkurajojnë ata që të punojnë me një qëllim në mendje.

- **Bëhu kreativ:** Shmangaj e monotonisë duke ndryshuar strukturën e klasës. Mësimi përmes lojërave dhe diskutimeve në vend të leksioneve, inkurajimi i studentëve të debatojnë dhe të pasurojnë lëndën me mjete vizuale, si tabela shumëngjyrëshe, diagrame dhe video. Mund të shfaqësh edhe një film që ilustron në mënyrë efektive një temë. Klasa juaj fizike nuk duhet të jetë kurrë e mërzitshme: përdorni postera, modele, projekte studentore dhe tema sezonale për të dekoruar klasën dhe për të krijuar një ambient të ngrohtë dhe stimulues.
- **Vizatoni lidhjet në jetën reale:** ‘Kur do të kem ndonjëherë nevojë për këtë?’. Kjo pyetje, e dëgjuar shpesh në klasë, tregon se një nxënës nuk është i angazhuar. Nëse një student nuk beson se ajo që ata po mësojnë është e rëndësishme, ata nuk do të duan të mësojnë, prandaj është e rëndësishme të demonstrohet se si lënda lidhet me ta. Nëse jeni duke mësuar algjebër, merrni pak kohë për të hulumtuar se si është përdorur praktikisht për shembull, në inxhinieri dhe për të ndarë gjetjet tuaja me nxënësit tuaj. Me të vërtetë i mahisin ata duke u thënë atyre se ata mund ta përdorin atë në karrierën e tyre. Duke u treguar atyre se një temë është përdorur çdo ditë nga njerëzit “realë”, ajo i jep rëndësi të re. Ata kurrë nuk mund të jenë të ngazëllyer për algjebër, por nëse shohin se si zbatohet për ta, ata mund të jenë të motivuar për të mësuar me vëmendje (Baker, 2002).

2.8. Teoritë e motivimit në edukim

Motivimi në vetvete ka një hapësirë të gjerë për t’u kujdesur dhe disa teori motivuese janë të rëndësishme për fushën e të mësuarit. Teoritë e paraqitura mëposhtëm kontribuojnë në rezultatet thelbësore të procesit mësimor pa u varur nga ndonjë teori tjetër në fushën e arsimit të cilat janë:

- Teoria e motivimit të jashtëm dhe të brendshëm.
- Teoria e vetëvendosjes (SDT),
- Modeli ARCS,
- Teoria konjitive shoqërore dhe
- Teoria e pritshmërisë (Positive Psychology, 2020).

2.8.1. Teoria e motivimit të jashtëm dhe të brendshëm

Janë kushtet kyçe, për të kuptuar më shumë dimensionin psikologjik të motivimit. Motivimi i brendshëm do të thotë diçka ekzistuese brenda nesh, e cila nuk vjen nga jashtë. Motivimi është përcaktuar si: “një shtytje e brendshme për t’u angazhuar apo për të kryer një veprim” (Nolen & Nichols, 1993).

Motivim “i jashtëm” do të thotë “diçka që vjen nga jashtë”. Motivimi i jashtëm i referohet stimujve të jashtëm të të nxënës, nëse bazohemi në nocionin biheiviorist të përforcimit. Në qoftë se nxënësit kanë motivim të jashtëm, ata angazhohen në një sjellje të caktuar, pasi “përgjigjet e parashikuara kënaqin nevojat e tyre (nevojat kryesore), ose janë një formë e modifikuar shoqërore për të kënaqur nevojat kryesore (p.sh: prestigji = nevojë dytësore)”, (Artelt, 2005).

Sipas një hulumtimi ku janë studiuar nxënësit që kryejnë detyra të lehta dhe të vështira, nën ndikimin e motivimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ata kanë zbuluar se, nxënësit të cilët kishin punuar në kushte të motivimit të brendshëm, vazhdonin të ishin të interesuar të punonin në detyra të vështira, ndërsa, nxënësit të cilët kishin punuar në kushte të motivimit të jashtëm, kishin humbur interesin e përpjekjeve drejt detyrave të vështira, duke preferuar të bënin vetëm ato më lehtat (Maehr & Stallings, 1972).

Një hulumtim tjetër ka arritur në përfundimin se nxënësit në grupin e motivimit të jashtëm ishin më shumë të orientuar për të dhënë përgjigje të dëshiruara, ndërsa nxënësit në grupin e motivimit të brendshëm ishin të prirur të përdornin qasje më kuptimplota për të kuptuar detyrat (Condry&Chambers, 1978).

Gjithashtu një hulumtim tjetër ka theksuar rëndësinë e forcave të jashtme të tilla si shpërblimet dhe dënimet. Ky raport nënkupton ndikimin e të tjerëve në kontekstin shkollor, për shembull: mësuesit janë zakonisht ata të cilët japin shpërblime dhe ndëshkime, kur shokët e klasës studiojnë dhe krahasohen me ta (Artelt, 2005).

Ndërsa, sipas (Harter&Jackson,1992) konfirmojnë rëndësinë e ndikimit nga të tjerët, veçanërisht nga mësuesit. Sipas tyre, motivimi i jashtëm është: “Orientimi, kur nxënësit janë të motivuar nga dëshira për të marrë nota të larta, për të fituar besimin e mësuesve. Pra, për të përmbushur kërkesat e jashtme të sistemit shkollor”.

Një teori tjetër e motivimit e ka klasifikuar motivimin e jashtëm në katër kategori:

1. I jashtëm: I cili kontrollohet nga të tjerët ose nga kufizimet e jashtme të tilla si, shpërblimet.
2. Ndikimi i të tjerëve; Në këtë rast kontrolli perceptohet si i jashtëm, pasi individi kërkon miratimin e të tjerëve.
3. Identifikues: Ku ka më shumë kontroll të brendshëm dhe vetë mbështetje të vlerave dhe qëllimeve.
4. Integruer: Pasqyron kontroll të lartë të brendshëm dhe harmoni midis vetes, vlerave dhe qëllimeve (Pintrich, 2003).

2.8.2. Teoria e vetëvendosjes (SDT)

Teoria e vetëvendosjes adreson më tej motivimin e brendshëm dhe të jashtëm. Ai e shpjegon atë në aspektin e vetë-rregullimit, ku motivimi ekstrem pasqyron kontrollin e jashtëm të sjelljes dhe motivimi i qenësishëm lidhet me vetë-rregullimin e vërtetë (Ryan, & Deci, 2000).

SDT na tregon se motivimi i brendshëm është i lidhur ngushtë me plotësimin e nevojave themelore psikologjike të autonomisë, kompetencës dhe lidhjes dhe ilustron sesi këto tendenca natyrore njerëzore lidhen me disa tipare kryesore në procesin e të mësuarit.

Këtu autonomia lidhet me vullnetin dhe pavarësinë dhe kompetenca shoqërohet me ndjenjën e efektivitetit dhe vetëbesimit në ndjekjen dhe përmbushjen e detyrave akademike. Lidhshmëria siguron ndjenjën e sigurisë dhe lidhjes me mjedisin mësimor, kur i tillë mundëson dhe rrit performancën dhe motivimin akademik të studentëve (Bauer, Orvis Ely & Surface, 2016).

Teoria e vetëvendosjes evoluoi nga pesë nën teori të tjera që mbështesin më tej pretendimet e saj.

1. Së pari, Teoria e Vlerësimit Kognitiv (CET), e cila shpjegon efektet e pasojave të jashtme në motivimin e brendshëm, tërheq vëmendjen tonë te roli kritik i autonomisë dhe i kompetencave që luajnë në nxitjen e motivimit të brendshëm, duke treguar sesi është jetësore në arsim, arte, sport, etj. shumë fusha të tjera.
2. Së dyti, Teoria e Integritit Organizativ (OIT) dhe Teoria e Orientimeve të Kauzalitetit (COT) shpjegojnë më tej motivimin ashtu siç ndodh përgjatë një spektri nga një fazë lëvizëse drejt shteteve motivuese ku përqendrimi është tek kompetencat.
3. Tjetra, Teoria Themelore e Nevojave Psikologjike (BPNT), e cila klasifikon nevojat njerëzore në tre nevoja kryesore psikologjike për autonomi, kompetencë dhe lidhje,

tregon se si kënaqësia e atyre nevojave është thelbësore për angazhimin, motivimin, përparimin e shëndetshëm dhe mirëqenien midis studentëve (Gagne, & Deci, 2014).

4. Në fund të fundit, Teoria e Përmbajtjes së Qëllimit (GCT) tregon lidhjen midis kënaqësisë së nevojave themelore dhe mirëqenies bazuar në motivimin e qëllimit të brendshëm dhe të jashtëm, ku qëllimet thelbësore çojnë në arritje më të mëdha dhe performancë më të mirë akademike, veçanërisht brenda vendosjes sociale të mjedisit arsimor (Ryan, & Deci, 2000).

2.8.3. Modeli ARCS

ARCS është një shkurtim për vëmendjen, relevancën, besimin dhe kënaqësinë. Modeli ARCS është një qasje ndaj modelit mësimor që përqendrohet në aspektet motivuese të mjedisit mësimor duke adresuar katër përbërës të motivimit:

1. Ngjalljes së interesit,
2. Krijim i rëndësisë,
3. Zhvillimin e një pritshmërie të suksesit dhe
4. Kënaqësi në rritje përmes shpërblimeve të brendshme dhe të jashtëm (Keller, 1983).

Modeli ARCS thekson tërheqjen e vëmendjes së studentëve si kritik për të fituar dhe mbajtur angazhimin e tyre në mësim dhe tregon se si kjo mund të arrihet përmes përdorimit të një mediumi tërheqës dhe stimulues ose material mësimor që është i rëndësishëm për përvojat dhe nevojat e tyre. Ajo njeh sesi besimi është i lidhur me parashikimin e nxënësve për sukses dhe se ndjenja pozitive në lidhje me procesin mësimor çojnë në kënaqësi më të madhe nga marrja e njohurive (Keller, 2008).

Tabela 1. Modeli i motivimit ARCS

Kategoritë kryesore dhe përkufizimet		Procesi i pyetjeve
Vëmendje	Kapja e interesit të nxënësve: Stimulimi i kureshtjes për të mësuar.	Si mund ta bëj këtë përvojë mësimore stimuluese dhe interesante?
Lidhja	Plotësimi i nevojave/qëllimeve personale të nxënësve për të dhënë një qëndrim pozitiv.	Në cilat mënyra do të jetë e vlefshme kjo përvojë mësimore për nxënësit e mu?

Besimi	Duke ndihmuar nxënësit të besojnë/ mendojnë se do të kenë sukses dhe kontrollojnë suksesin e tyre.	Si mund t'i ndihmoj me udhëzime nxënësit të kenë sukses dhe t'i lejojnë ata të kontrollojnë suksesin e tyre?
Kënaqësia	Duke forcuar realizimin me shpërblime.	Çfarë mund të bëj për t'i ndihmuar nxënësit të ndjehen mire me përvojën dhe dëshirën e tyre për të vazhduar mësimin.

2.8.4. Teoria kognitive sociale

Teoria kognitive sociale (SCT), e zbatuar sot në fusha të ndryshme nga arsimi dhe komunikimi deri tek psikologjia, i referohet përvetësimit të njohurive përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë, ndërveprimit, përvojave dhe ndikimit të jashtëm të mediave (Bryant, & Oliver, 2002).

Ai mbështetet në supozimin se ne ndërtojmë kuptim dhe fitojmë njohuri edhe pse ndikim shoqëror nga komunikimi i përditshëm deri në përdorimin e internetit dhe shpjegon marrëdhëniet midis sjelljes, mjedisit shoqëror dhe fizik dhe faktorëve personalë. SCT ilustron se si njerëzit fitojnë dhe mirëmbajnë disa modele të sjelljes dhe sigurojnë strategji themelore të ndërhyrjes si të mësuarit ndërveprues, i cili lejon nxënësve të fitojnë besim përmes praktikës (Bandura, 1997).

2.8.5. Teoria e pritshmërisë

Teoria e pritshmërisë, e zhvilluar fillimisht për të shpjeguar se si mjedisi i punës mund të motivojë punonjësit, përpiket të tregojë lidhjen midis pritjeve të suksesit dhe parashikimit të shpërblimeve dhe sasisë së përpjekjeve të shpenzuara në një detyrë dhe si lidhet me performancën e përgjithshme (Hema Malini, & Uashington, 2014).

E thënë thjesht, shpjegon motivimin si zgjedhje bazuar në pritshmërinë e rezultateve të sjelljes së zgjedhur.




Figura 1. Modeli i teorisë së pritshmërisë.

Teoria e pritshmërisë shpjegon motivimin në drejtim të arsyeve që ne përfshijmë në sjellje specifike ku ne presim që përpjekja të çojë në performancë më të mirë, e cila nga ana tjetër do të çojë në shpërblime me vlerë. Në kontekstin arsimor kjo do të përkthehet në perceptimin e nxënësve se përpjekja e tyre do të çojë në performancë të mirë ose më të mirë (pritshmëri) e ndjekur nga studentët besimin se performanca e tyre do të çojë në arritjen e qëllimit dhe shpërblimeve të dëshiruara (instrumentalitetin) dhe së fundmi, vlera e shpërblimeve janë të kënaqshme dhe mbështesin qëllimet e studentit (valenca) (Bauer, 2016).

2.9. Ndikimi i motivimit të mësuesve në performancën akademike të nxënësve

Termi motivim përmbledh në vetvete një sërë përbërësish që janë të lidhur me plotë ndjesi e stimuj të ndryshëm, të brendshëm ose të jashtëm, të lindur ose të mësuar gjatë jetës. Ata vihen në funksion të pritjeve për të arritur suksesin e dëshiruar, për të plotësuar nevojat, për të reaguar në mënyrë të përshtatshme ndaj stimujve dhe për të shmangur rrezikun nga dështimet. Përmes motivimit parandihen ose parashikohen rrjedhojat e mundshme të mjaft sjelljeve apo veprimeve. Motivimi nuk është një pikë nisje por një proces që na shoqëron në çdo veprim tonin. Ajo çka vlen për të diskutuar është pikërisht fakti si mund të rritim sa më shumë shkallën e motivimit në të gjithë aktorët e sistemit arsimor për të pasur një produkte sa më të motivuar e më mirë që është nxënësi.

Prandaj, ndikimi i motivimit të mësuesve në performancën akademike të nxënësve janë:

- Një mësues që është i motivuar do të bëjë më shumë përpjekje që në klasë të kalojë njohuri të nxënësve të tij në mënyrë që të ndikojë në sjelljen e zbuluesit në mënyrën më të dëshiruar dhe pozitive.
- Motivimi i mësuesve është kaq thelbësor për performancën akademike të nxënësve sepse shpjegon pse mësuesit sillen ashtu si veprojnë në shkollat e tyre të ndryshme. Sipas disa hulumtime u vë në dukje se motivimi i mësuesve është forca që energjizon, drejton dhe siguron përpjekjet e mësimit të nxënësve (Borman, 2003).
- Motivet janë dëshira për të arritur qëllimet. Kështu, këto dëshira më të forta janë të pranishme gjatë takimit të mësimit - mësimit të nxënësve, aq më i madh do të jenë përpjekjet për arritjen e këtyre qëllimeve. Prandaj, motivimi i mësuesve siguron që mësuesit dhe nxënësit të mbajnë përpjekjet e tyre në një përpjekje për të arritur objektivat e pritshëm të takimit në klasë.
- Mësuesi që është i motivuar ndihmon nxënësit përkatës që të fitojnë më shumë mundësi të dukshme ndaj shkollës në përgjithësi dhe të nxënësve në veçanti.
- Motivimi i mësuesit siguron dëshirën tek nxënësit për të mësuar. Kjo pasi që mësuesit janë inkurajuar të mësojnë, të shprehin veten përmes përgjigjeve, duke marrë pjesë si në detyra individuale ashtu edhe në grupe, nxënësit përfshihen ose angazhohen në procesin e të mësuarit duke përvetësuar ide, aftësi dhe koncepte për zhvillimin e plotë.
- Meqenëse motivimi i mësuesve u siguron mësuesve dëshirën për të mësuar nxënësit e tij, kjo rezulton që studentët të marrin nota më të mira, të zhvillojnë potenciale më të larta përvetësimi dhe vetë-koncept më të mirë etj. (Orji Friday OKO, 2014).

III. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Është shumë me rëndësi që para se të fillojmë me shpjegimin e metodave të kërkimit, të definojmë se çfarë mendojnë autorët e tjerë rreth konceptit të metodologjisë së punës.

Sipas Mazreku.I, metodologjia mund të jetë shkencë e përgjithshme ose e kufizuar në një të veçantë, apo kërkim specifik. Metodologjia nisët nga format logjike të procesit të njohurive dhe nga mundësia e zbatimit të tyre në shkencë të caktuar ose të një kërkimi të caktuar shkencor.

Sipas Irny dhe Rose-2015, metodologjia është analizë sistematike, teorike e metodave të aplikuar në një fushë studimit. Ai përfshin analizën teorike të trupit të metodave dhe parimeve që lidhen me një degë të njohurive (Researchgate, 2016).

Metodologjitë e përdorua në këtë punim janë:

- **Metodologjia e kërkimit:** Kjo metodologji përfshin mbledhjen e të dhënave relevante nga metoda të ndryshme kërkimore dhe përpilimin e bazave të të dhënave në mënyrë që të analizohen të dhënat dhe të arrihet ndërtimi i duhur i projektit hulumtues.
- **Metodologjia e mbledhjes së të dhënave sekondare:** Analiza dhe hulumtimi të dhënave është ndërmarrë me kujdes të veçantë, duke dashur të fitoj një kuptim më të gjerë dhe efektiv në lidhje me pyetjet kërkimore.

3.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi është të tregohet se si ndikon motivimi tek nxënësit për arritjet e tyre akademike, duke nxitur dhe prirë proceseve të motivimit të mësimdhënësve. Po ashtu përpiqet të sigurojë se cilat metoda të motivimit i përdorin mësimdhënësit për motivimin e nxënësve.

Në këtë hulumtim po ashtu do të elaburohet se cilat teknika të motivimit ndikojnë më së shumti në motivimin e nxënësve.

3.2. Detyrat e hulumtimit

Detyrat kryesore në këtë hulumtim janë:

- Të zbulohen se cilat teknika ndikojnë më së shumti në motivimin e nxënësve.
- Të zbulohet shkalla e motivimit të mësimit të nxënësve.
- Të tregohet motivimi tek nxënësit nga ana e mësimit të nxënësve e cila ndikon në arritjet e sukseseve akademike.

3.3. Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezave

Pyetjet e parashtruar në këtë hulumtim janë:

- A ka efekt motivimi i nxënësit në arritjet e shkollës?
- Cili është roli i drejtorit në motivimin e mësimit të nxënësve?
- Sa është e lartë shkalla e motivimit tek nxënësit?
- Cili është roli i mësuesit në motivimin e nxënësve për arritjen dhe dëshirën për suksese?
- Cilat teknika ndikojnë më së shumti në motivimin e nxënësve?

Në bazë të pyetjeve të këtij hulumtimit janë ndërtuar edhe hipoteza e këtij hulumtimit të cilat janë:

- Motivimin ka efekt tek nxënësit në arritjet e shkollës.
- Drejtori luan një rol të rëndësishëm në motivimin e mësimit të nxënësve.
- Shkalla e motivimit është e lartë tek nxënësit.

3.4. Grupi reprezentativ

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 720 pjesëmarrës. Janë përzgjedhur nga 100 nxënës në shkollën fillore “Fan Noli” - Kamenicë, në shkollën fillore “Thimi Mitko” - Gjilan, në shkollën fillore “Avni Rustemi” - Prishtinë, në shkollën fillore “Dardania” - Pejë, në shkollën fillore “Avdyl Frashëri” - Prizren dhe në shkollën fillore “Mihal Grameno” - Fushë Kosovë.

Ndërsa, pjesëmarrësit tjerë në këtë hulumtim janë edhe 120 mësimit të nxënësve të shkollës së njëjtë.

3.5. Metodatat, instrumentet dhe procedurat e hulumtimit

Ky hulumtim është realizuar në Republikën e Kosovës, përkatësisht në komunën e Kamenicës,

Gjilan, Prishtinë, Pejë, Prizren dhe Fushë Kosovë.

Gjatë këtij studimi, nëse i referohemi metodës së hulumtimit, është përdorur metodat kuantitative ku të dhënat e studimit janë të mbledhura përmes pyetësorit. Si dizajn i hulumtimit është zgjidhur dizajni kompleks, si dizajnë më i përshtatshëm për të shikuar ndikimin e dy apo më shumë variabla të pavarura në variabla të varura dhe ndërveprimin e tyre.

Fillimisht me ndihmën e hulumtimeve të ndryshme, janë gjetur pyetjet të përshtatshme me temën time. Më pas është bërë përkthimi dhe përshtatja e pyetësorit.

Në ndërkohë është paraqitur kërkesa për aprovimin e pyetësorit tek drejtorët e shkollave të paraparë për këtë hulumtim. Të anketuarve të cilët janë përzgjedhur të marrin pjesë në hulumtim janë të informuar paraprakisht dhe se përgjigjet e tyre janë anonime dhe do të përdoren për nxjerrjen e rezultateve të një punimi të diplomës, dhe se nuk do përdoren për qëllime të tjera. Çdo pyetje autori e ka sqaruar në mënyrë që të anketuarit mos të përballen me vështirësi dhe mos të ndjehen konfuz, sepse në këtë mënyrë rezultatet dalin sa më reale që është e mundur. Kohëzgjatja për plotësimin e pyetësor ka qenë 20 min.

Pasi që janë plotësuar pyetësorët janë analizuar përgjigjet e pyetësorëve duke i nxjerr rezultatet me përqindje, në tabela përmes programit SPSS (Paketën Statistike të Shkencave Sociale 21).

3.6. Instrumenti i hulumtimit

Si instrument matës në këtë pyetësorë janë përdorur dy pyetësorë, të cilët kanë të bëjnë me motivimin e nxënësve në shkollë si dhe motivimin e mësimit në mësimdhënësive.

Pyetësori për nxënësit përbëhet nga 15 pyetje në të cilat janë të përfshirë edhe pyetjet demografike. Nxënësit kanë pasur mundësi kryesisht të rrethojnë vetëm një përgjigje (1=Po, 2=Pjesërisht dhe 3=Jo).

Ndërsa, pyetësori për mësimitdhënësit përbëhet nga 19 pyetje, në të cilën kryesisht kanë pasur mundësi të rrethojnë vetëm një përgjigje (1=Mirë, 2=Mjaftueshëm dhe 3=Dobët) dhe (1=Po, 2=Pjesërisht, 3= Jo).

Pyetësori është anonim në mënyrë që pjesëmarrësit e hulumtimit të jenë të lirë në dhënien e përgjigjeve të tyre. Me anë të përgjigjeve të dhëna nga pyetësori tentohet të kuptojmë “Sa ka efekt motivimi tek nxënësit në suksesin e tyre?”

IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

Me qëllim që të elaburojmë tezen në mënyrë më të thellë, ne iu qasëm një hulumtimi. Hulumtimi është realizuar nga data 10.05.2020 deri më 24.05.2020 në Republikën e Kosovës, më saktësisht në shkollat fillore “Fan Noli” në Kamenicë, “Thimi Mitko” në Gjilan, “Avni Rrustemi” në Prishtinë, “Dardania” në Pejë, “Avdyl Frashëri” në Prizren dhe “Mihal Grameno” në Fushë Kosovë.

Për arsyeje të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar në mbarë botën, ky hulumtim është realizuar në mënyrën online. Me ndihmën e kolegeve kam rënë në kontakte me drejtorët e këtyre shkollave, në të cilën më kanë mundësuar që të realizojë këtë hulumtim duke më drejtuar tek mësimdhënësit e shkollave fillore.

Prandaj, në kapitullin vijues është bërë interpretimi i rezultateve të fituar me anë të pyetësorit, në të cilën do të na mundësojnë të vërtetojmë ose hedhim poshtë hipotezat e ngritura në fillim të këtij hulumtim, gjithashtu përmes këtyre rezultateve do të arrijmë tek realizimi i qëllimit të këtij hulumtimi.

4.1. Të dhënat nga pyetësori me nxënësit

Në këtë nënkapitull janë të paraqitura rezultatet e fituar nga anketimi me nxënësit.

Tabela 2. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe shkollës.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Shkolla	Shkolla Fillore “Fan Noli”	47	15.7%	53	17.5%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Thimi Mitko”	36	13.6%	64	20.0%	100	16.6 %
	Shkolla Fillore “Avni Rrustemi”	54	19.3%	46	14.3%	100	16.6%

	Shkolla Fillore “Dardania”	39	14.3%	61	19.0%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Abdyl Frashëri”	59	21.0%	41	12.0%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Mihal Grameno”	45	16.1%	55	17.2%	100	16.6%
	Totali	280	100.0 %	320	100.0%	600	100.0%

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitura të dhënat e strukturës gjinore dhe shkollës së nxënësve të cilët janë pjesëmarrës në këtë hulumtimi.

Nga shkolla fillore “Fan Noli” në këtë pyetësor morën pjesë 47 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 53 nxënës të gjinisë femërore.

Nga shkolla fillore “Thimi Mitko” pjesëmarrës në këtë hulumtimi janë 36 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 64 pjesëmarrës të gjinisë femërore.

Nga shkolla fillore “Avni Rrustemi” pjesëmarrës në këtë hulumtim janë 54 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 46 nxënës të gjinisë femërore.

Nga shkolla fillore “Dardania” pjesëmarrës në këtë hulumtim janë 39 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 61 nxënës të gjinisë femërore.

Nga shkolla fillore “Abdyl Frashëri” pjesëmarrësit e këtij hulumtimi janë 59 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 41 nxënës të gjinisë femërore.

Nga shkolla fillore “Mihal Grameno” pjesëmarrës të këtij hulumtimi janë 45 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 55 nxënës të gjinisë femërore.

Këto të dhëna tregojnë se numri më i madhe i nxënësve pjesëmarrës në këtë hulumtim janë të gjinisë femërore. Në të cilat nga totali i pjesëmarrësve në këtë hulumtim, 54% prej tyre janë të gjinisë femërore dhe 46% e nxënësve në këtë hulumtim janë të gjinisë mashkullore.

Tabela 3. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe suksesit në shkollë.

	Gjinia					
	Mashkull		Femër		Totali	
	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)

Suksesi	Arritje minimale	2	0.70%	1	0.3%	3	0.5%
	Arritje mesatare	16	5.7%	22	6.9%	38	6.33%
	Arritje e kënaqshme	70	25.0%	81	25.3%	151	25.1%
	Arritje e plotë	192	68.6%	216	67.5%	408	68.0%
	Totali	280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Në tabelën nr.3 janë paraqitur rezultatet të raportit në mes suksesit të nxënësve në shkollë dhe gjinisë së pjesëmarrëseve që morën pjesë në këtë hulumtim.

Në arritjen minimale janë përgjigjur 3 pjesëmarrës, në të cilën 2 nxënës janë të gjinisë mashkullore dhe 1 nxënës është e gjinisë femërore.

Në arritjen mesatare janë përgjigjur 38 nxënës, të cilët të gjinisë mashkullore janë 16 nxënës dhe 22 nxënës të gjinisë femërore.

Në nivelin e arritjes së kënaqshme janë përgjigjur 151 nxënës, të cilët 70 prej tyre janë të gjinisë mashkullore dhe 81 nxënës të gjinisë femërore.

Në arritjen e plotë janë përgjigjur 408 nxënës, në të cilën 192 nxënës janë të gjinisë mashkullore dhe 216 nxënës janë të gjinisë femërore.

Këto të dhëna tregojnë se arritje minimale kanë 0.5% nga totali i pjesëmarrëseve të hulumtimit, në arritjen mesatare kanë pohuar 6.33%, në arritjen e kënaqshme kanë pohuar 25.1% e pjesëmarrëseve dhe në arritjen e plotë janë përgjigjur 68.0% nga totali i pjesëmarrëseve të këtij hulumtimi.

Tabela 4. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe metodave të përdorur nga mësimdhënësit.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Metodat e përdorur nga mësimdhënësit	Shkolla Filllore "Fan Noli"	21	16.0%	79	17.5%	100	16.6%
	Shkolla Filllore "Thimi Mitko"	32	24.4%	68	14.0%	100	16.6%
	Shkolla Filllore "Avni Rrustemi"	11	8.4%	89	19.0%	100	16.6%

	Shkolla Fillore “Dardania”	21	16.0%	79	16.5%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Abdyl Frashëri”	16	12.2%	84	17.9%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Mihal Grameno”	30	23.0%	70	15.1%	100	16.6%
	Totali	131	100.0%	469	100.0%	600	100.0%

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitura rezultatet të cilat tregojnë se çfarë metoda mësimdhënësit e pjesëmarrëseve përdorin nëpër shkolla.

Nxënësit e shkollës fillore “Fan Noli” kanë pohuar 21 nxënës se mësimdhënësit e tyre shpjegojnë gjatë gjithë kohës dhe 79 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit i bëjnë nxënësit pjesëmarrës. Në shkollën fillore “Thimi Mitko” kanë pohuar 32 nxënës se mësimdhënësit e tyre shpjegojnë gjatë gjithë kohës dhe në opsionin i bën nxënësit pjesëmarrës janë përgjigjur 68 nxënës.

Në shkollën fillore “Avni Rrustemi” janë përgjigjur në opsionin se mësimdhënësit shpjegojnë gjatë gjithë kohës 11 nxënës dhe në opsionin i bën nxënësit pjesëmarrës janë përgjigjur 89 nxënës.

Në shkollën fillore “Dardania” janë përgjigjur 21 nxënës se mësimdhënësit e tyre shpjegojnë gjatë gjithë kohës 21 dhe në opsionin i bën nxënësit pjesëmarrës janë përgjigjur 79 nxënës.

Në shkollën fillore “Abdyl Frashëri” janë përgjigjur 16 nxënës se mësimdhënësi i tyre shpjegojnë gjatë gjithë kohës dhe në opsionin i bën nxënësit pjesëmarrës janë përgjigjur 84 nxënës.

Në shkollën fillore “Mihal Grameno” janë përgjigjur 30 nxënës në opsionin se mësimdhënësi i tyre shpjegojnë gjatë gjithë kohës dhe në opsionin i bën nxënësit pjesëmarrës janë përgjigjur 70 nxënës.

Këto të dhëna tregojnë se numri më i madhe i mësimdhënëseve i bën nxënësit pjesëmarrës në mësim, por megjithatë sipas këtyre rezultatet ekziston ende një numër i mësimdhënëseve që vetëm shpjegojnë gjatë gjithë kohës.

Tabela 5. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe motivimit të nxënësve për të frekuentuar shkollën.

	Gjinia					
	Mashkull		Femër		Totali	
	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)

Motivimi për të frekuentuar shkollën	Po	258	92.0%	290	91.0%	548	92.0%
	Pjesërisht	13	5.0%	24	7.5%	37	5.5%
	Jo	9	3.0%	6	1.5%	15	2.5%
	Totali	280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Në tabelën e mësipërme është bërë krahasimi i rezultateve të strukturës gjinore dhe motivimit të nxënësve për të frekuentuar shkollën.

Të dhënat tregojnë se 258 nxënës të gjinisë mashkullore janë të motivuar për të frekuentuar shkollën, pjesërisht janë të motivuar për të frekuentuar shkollën 13 nxënës të gjinisë mashkullore dhe nuk janë të motivuar për të frekuentuar shkollën 9 nxënës të gjinisë mashkullore.

Nga gjinia femërore janë 290 nxënës të motivuar për të frekuentuar shkollën, 24 nxënës të gjinisë femërore janë pjesërisht të motivuar për të frekuentuar shkollën dhe nuk janë të motivuar për të frekuentuar shkollën 6 nxënës të gjinisë femërore.

Ndërsa, nga të dhënat totale të pjesëmarrëseve të hulumtimit, të dhënat tregojnë se 92.0% e nxënësve janë të motivuar për të frekuentuar shkollën, 5.5% nga totali janë të motivuar pjesërisht për të frekuentuar shkollën dhe 2.5% e pjesëmarrëseve nuk janë të motivuar për të frekuentuar shkollën.

Tabela 6. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe motivimit për të mësuar.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Motivimi për të mësuar	Po	219	78.2%	294	92.0%	513	85.5%
	Pjesërisht	57	20.3%	19	6.0%	76	13.5%
	Jo	4	1.5%	7	2.0%	11	1.0%
	Totali	280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë përdorur për të krahasuar strukturën gjinore të nxënësve dhe motivimit për të mësuar.

Sipas të dhënave të fituar nga pyetësi, 219 nxënës të gjinisë mashkullore janë 219 nxënës kanë pohuar se janë të motivuar për të mësuar, pjesërisht janë të motivuar për të mësuar 57 nxënës të

gjinisë mashkullore dhe nuk janë të motivuar për të mësuar 4 nxënës të gjinisë mashkullore. Ndërsa, pjesëmarrësit e gjinisë femërore janë të motivuar për të mësuar 294 nxënës, pjesërisht janë të motivuar për të mësuar 19 nxënës dhe nuk janë të motivuar për të mësuar 7 nxënës të gjinisë femërore.

Këto të dhëna janë të rëndësishme për arsyeje se tregojnë se nga totali i pjesëmarrëseve në këtë hulumtim janë të motivuar për të mësuar 85.5% e pjesëmarrëseve, pjesërisht janë të motivuar për të mësuar 13.5% e pjesëmarrëseve dhe nuk janë të motivuar për të mësuar 1% nga totali i pjesëmarrëseve.

Tabela 7. Krahasimi i variablave të shkollës dhe mënyrave për të nxitur nxënësit për të mësuar.

		Mënyra për të nxitur nxënësit për të mësuar					
		Vlerësimi me anë të notës		Vlerësimi simbolik		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Shkolla	Shkolla Fillore “Fan Noli”	68	24.5%	32	9.90%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Thimi Mitko”	33	12.0%	67	21.1%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Avni Rustemi”	59	21.0%	41	12.7%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Dardania”	29	10.0%	71	22.0%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Abdyl Frashëri”	49	18.5%	51	16.0%	100	16.6%
	Shkolla Fillore “Mihal Grameno”	39	14.0%	61	18.3%	100	16.6%
	Totali	277	100.0%	323	100.0%	600	100.0%

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë përdorur për të krahasuar të dhënat në mes metodave të nxitjes për të mësuar dhe shkollat pjesëmarrëse të këtij hulumtimi.

Nga totali i nxënësve pjesëmarrës në këtë hulumtim të shkollës fillore “Fan Noli”, rezultatet tregojnë se 68 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit përdorin vlerësimin me anë të notës si metodë e nxitjes për të mësuar dhe 32 nxënës janë përgjigjur se mësimdhënësit e tyre si metodë

nxitje për të mësuar përdorin vlerësimin simbolik.

Në shkollën fillore “Thimi Mitko”, 33 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit e tyre përdorin vlerësimin me anë të notës si metodat e nxitjes për të mësuar dhe 32 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit e tyre përdorin vlerësimin simbolik si metodë e nxitjes për të mësuar.

Në shkollën fillore “Avni Rrustemi”, 59 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit e tyre si metodë nxitëse për të mësuar përdorin vlerësimin me anë të notës dhe 41 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit e tyre i nxitin për të mësuar përmes vlerësimit simbolik.

Në shkollën fillore “Dardania”, 29 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit e tyre përdorin vlerësimin me anë të notës për nxitjen e të mësuarit dhe 71 nxënës janë përgjigjur se mësimdhënësit përdorin vlerësime simbolike për nxitjen e të mësuarit.

Në shkollën fillore “Abdyl Frashëri”, mësimdhënësit si metodë nxitje për të mësuar përdorin vlerësimin me anë të notës kanë pohuar 49 nxënës dhe si metodë për nxitje në të mësuarin përdorin vlerësimin simbolik kanë pohuar 51 nxënës.

Në shkollën fillore “Mihal Grameno”, 39 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit e tyre përdorin vlerësimin me anë të notës për nxitjen e të mësuarit dhe 61 nxënës janë përgjigjur se mësimdhënësit e tyre përdorin vlerësime simbolike për nxitjen e të mësuarit.

Pra, këto të dhëna tregojnë se nga totali i pjesëmarrëseve të këtij hulumtimi, 277 nxënës kanë treguar se mësimdhënësit i nxitin për të mësuar përmes vlerësimit me anë të notës dhe 323 nxënës i nxitin për të mësuar përmes vlerësimit simbolik.

Tabela 8. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe metodave apo teknikave që thjeshtojnë mësimin.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Metodat dhe teknikat që thjeshtojnë mësimin	Po	248	88.6%	301	94.0%	549	91.5%
	Pjesërisht	28	10.0%	18	5.5%	46	7.5%
	Jo	4	1.4%	1	0.5%	5	1.0%
Totali		280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitur të dhënat që përdoren për të krahasuar metodat dhe teknikat që e thjeshtojnë mësimin në krahasim me strukturën e gjinisë.

Nga totali i pjesëmarrëseve (n=600) 248 nxënës të gjinisë mashkullore kanë pohuar se mësimdhënësit e tyre përdorin metodat apo teknikat që thjeshtojnë mësimin, pjesërisht kanë pohuar 28 nxënës të gjinisë mashkullore dhe kanë mohuar 4 nxënës.

Ndërsa, 549 nxënës të gjinisë femërore kanë pohuar se mësimdhënësit përdorin metodat apo teknikat që thjeshtojnë mësimin, pjesërisht kanë pohuar 46 nxënës dhe kanë mohuar 5 nxënës.

Tabela 9. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe inkurajimi nga ana e mësimdhënëseve tek nxënësit me fjalë të ngrohta.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Inkurajimi nga ana e mësimdhënëseve me fjalë të ngrohta	Po	224	80.0%	311	96.5%	535	89.0%
	Pjesërisht	46	16.5%	6	2.5%	52	8.5%
	Jo	10	3.5%	3	1.0%	13	2.5%
Totali		280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë përdorur për të krahasuar inkurajimin e mësimdhënëseve me fjalë të ngrohta dhe strukturën e gjinisë.

Pjesëmarrësit e gjinisë mashkullore kanë pohuar 224 nxënës se mësimdhënësit i inkurajon ata me fjalë të ngrohta, pjesërisht kanë pohuar 46 nxënës dhe 10 nxënës kanë pohuar se mësimdhënësit e tyre nuk i inkurajojnë ata me fjalë të ngrohta.

Pjesëmarrësit e gjinisë femërore kanë pohuar 311 nxënës se mësimdhënësit i inkurajojnë ata me fjalë të ngrohta, pjesërisht kanë pohuar 6 nxënës dhe kanë pohuar 3 nxënës se mësimdhënësit nuk i inkurajojnë ata me fjalë të ngrohta.

Këto të dhëna janë të rëndësishme për arsyeje se tregojnë se nxënësit e gjinisë femërore inkurajohen më shumë për të mësuar nga fjalët e ngrohta të mësimdhënëseve.

Tabela 10. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe vlerësimit nga ana e mësimdhënëseve.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Vlerësim nga ana e mësimdhënëseve	Po	270	96.5%	304	95.0%	574	95.0%
	Pjesërisht	10	3.5%	14	4.5%	24	4.0%
	Jo	0	-	2	0.5%	2	1.0%
Totali		280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë përdorur për të krahasuar rezultate e strukturës gjinore dhe vlerësimit të nxënësve nga ana e mësimdhënëseve.

Të dhënat tregojnë se 270 nxënës të gjinisë mashkullore ndihen të vlerësuar nga ana e mësimdhënëseve të tyre, pjesërisht kanë pohuar 10 nxënës dhe nuk ka mohuar asnjë nxënës i gjinisë mashkullore.

Ndërsa, 304 nxënës të gjinisë femërore kanë pohuar se ndihen të vlerësuar nga ana e mësimdhënëseve të tyre, 14 nxënës pjesërisht kanë pohuar se ndihen të vlerësuar nga ana e mësimdhënëseve dhe 2 nxënës kanë mohuar se ndjehen të vlerësuar nga ana e mësimdhënëseve.

Tabela 11. Krahasimi i strukturës së gjinisë dhe bashkëveprimit me shokët e klasës.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Bashkëveprimi me shokët e klasës	Po	277	99.0%	316	98.5%	593	99.0%
	Pjesërisht	3	1.0%	4	1.5%	7	1.0%
	Jo	0	-	0	-	0	-
Totali		280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme tregojnë se 277 nxënës të gjinisë mashkullore kanë pohuar se bashkëveprojnë me shokët e klasës, 3 nxënës kanë pohuar pjesërisht se bashkëveprojnë me shokët e klasës dhe asnjë nga pjesëmarrësit nuk ka pohuar se nuk bashkëveprojnë me shokët e klasës.

Ndërsa, nxënëset e gjinisë femërore kanë pohuar 316 prej tyre se bashkëveprojnë me shokët e klasës, pjesërisht kanë pohuar 4 nxënëse të gjinisë femërore dhe nuk kanë pohuar asnjë nga pjesëmarrësit e gjinisë femërore se nuk bashkëveprojnë me shokët e klasës.

Të dhënat në përgjithësi tregojnë se 99.0% e pjesëmarrëseve në këtë hulumtim bashkëveprojnë me shokët e klasës dhe 1.0% e pjesëmarrëseve në këtë hulumtim kanë pohuar se pjesërisht bashkëveprojnë me shokët e klasës.

Tabela 12. Krahasimi i strukturës gjinore dhe klima në klasë.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Klima në klasë	Po	279	99.5%	318	99.5%	597	99.5%
	Pjesërisht	1	0.5%	2	0.50%	3	0.50%
	Jo	0	-	0	-	0	-
	Totali	280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitura rezultatet të cilat janë përdorur për të krahasuar variablat e strukturës gjinore dhe klimës në klasë.

Të dhënat tregojnë se 279 nxënës të gjinisë mashkullore kanë pohuar se kanë klimë të mirë në klasë dhe pjesërisht kanë klimë të mirë në klasë ka pohuar një nxënës.

Nxënësit e gjinisë femërore kanë pohuar 318 prej tyre se kanë klimë të mirë në klasë dhe pjesërisht ka klimë të mirë në klasë kanë pohuar 2 nxënëse.

Këto të dhëna tregojnë se 99.5% e nxënëse kanë pohuar se kanë klimë të mirë në klasë dhe 0.50% nga pjesëmarrësit e këtij hulumtim kanë pohuar se pjesërisht kanë klimë të mirë në klasë,

ndërsa asnjë nga pjesëmarrësit e këtij hulumtimi nuk kanë mohuar se kanë klimë të mirë në klasë.

Tabela 13. Krahasimi i strukturës gjinore dhe stresit në klasë.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Stresi në klasë	Po	1	0.30%	3	0.90%	4	0.70%
	Pjesërisht	2	0.60%	2	0.60%	4	0.70%
	Jo	277	99.1%	315	98.5%	592	98.6%
	Totali	280	100.0%	320	100.0%	600	100.0%

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitura rezultatet të cilat tregojnë krahasimin e variablave të strukturës gjinore dhe stresit në klasë.

Nxënësit e gjinisë mashkullore nga totali i pjesëmarrëseve 1 nxënës ka pohuar se ka stres në klasë, 2 nxënës të gjinisë mashkullore kanë pohuar se pjesërisht se kanë stres në klasë dhe 277 nxënës të gjinisë mashkullore kanë pohuar se nuk kanë stres në klasë.

Ndërsa, nxënëset e gjinisë femërore kanë pohuar 4 prej tyre se kanë stres në klasë, 4 nxënëse kanë pohuar se pjesërisht kanë stres në klasë dhe 315 nxënëse të gjinisë femërore kanë pohuar se nuk kanë stres në klasë.

Të dhënat në përgjithësi tregojnë se 0.70% e pjesëmarrëseve në këtë hulumtim kanë stres në klasë, 0.70% e pjesëmarrëseve në këtë hulumtim kanë pohuar se pjesërisht kanë stres në klasë dhe 98.6% nga totali i pjesëmarrëseve kanë pohuar se nuk kanë stres në klasë.

4.2 Të dhënat me pyetësor nga mësimdhënësit

Në këtë nënkaptull janë paraqitur të dhënat e marruar nga pyetësi i realizuar me mësimdhënësit, në të cilën janë anketuar 60 mësimdhënëse, të shkollave pjesëmarrëse në këtë hulumtim.

Tabela 14. Krahasimi i variablave të strukturës gjinore të mësimeve dhe kushtet në shkollë.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Kushtet në shkollë	Po	20	95.3%	37	95.4%	57	95.0%
	Pjesërisht	1	4.7%	2	4.6%	3	5.0%
	Jo	0	-	0	-	0	-
Totali		21	100.0%	39	100.0%	60	100.0%

Në tabelën e mësipërme janë të paraqitur të dhënat të cilat tregojnë krahasimin e variablave të strukturës gjinore të mësimeve dhe kushteve në shkollë.

Nga totali i pjesëmarrëseve të mësimeve në këtë hulumtim (n=60), 20 mësimeve të gjinisë mashkullore dhe 37 mësimeve të gjinisë femërore kanë pohuar se i kanë kushtet e mira në shkollë.

Pjesërisht kanë pohuar se i kanë kushte të mira të punës në shkollë 1 mësimeve të gjinisë mashkullore dhe 2 mësimeve të gjinisë femërore.

Ndërsa, asnjë mësimeve nuk ka pohuar se nuk janë kushte e mira në shkollë.

Të dhënat në përgjithësi tregojnë se 95.0% e pjesëmarrëseve të këtij hulumtimi kanë kushte të mira në punë dhe 5.0% e pjesëmarrëseve kanë pohuar se pjesërisht i kanë kushte të mira në punë.

Tabela 15. Krahasimi i variablave të strukturës gjinore dhe mjedisit brenda punës.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Mjedisi brenda punës	Po	21	100.0%	38	98.0%	59	98.5%
	Pjesërisht	0	-	1	2.0%	1	1.5%

		0	-	0	-	0	-
	Totali	21	100.0%	39	100.0%	60	100.0%

Në tabelën nr.15 janë të paraqitura të dhënat të cilat tregojnë krahasimin e variablave të strukturës gjinore dhe mjedisit brenda punës.

Mësimdhënësit e gjinisë mashkullore kanë pohuar 21 prej tyre se janë të kënaqur me mjedisin brenda punës së tyre.

Ndërsa, 38 mësimdhënëse të gjinisë femërore kanë pohuar se janë të kënaqur me mjedisin brenda punës dhe 1 mësimdhënëse ka pohuar se pjesërisht nuk është e kënaqur me mjedisin brenda punës.

Këto të dhëna tregojnë se nga totali i pjesëmarrëseve 98.5% prej tyre janë të kënaqur me mjedisin brenda punës dhe 1.5% prej tyre ka pohuar se pjesërisht janë të kënaqur me mjedisin brenda punës. Ndërsa, asnjë nga pjesëmarrësit e këtij hulumtimi nuk kanë mohuar se ju kënaq mjedisi brenda punës.

Tabela 16. Krahasimi i variablave të strukturës së gjinisë dhe mbështetjes nga ana e drejtorit.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Mbështetje nga ana e drejtorit	Po	21	100.0%	39	100.0%	60	100.0%
	Pjesërisht	0	-	0	-	0	-
	Jo	0	-	0	-	0	-
	Totali	21	100.0%	39	100.0%	60	100.0%

Të dhënat në tabelën e mësipërme janë përdorur për të krahasuar variablat e strukturës së gjinisë dhe mbështetjes nga ana e drejtorit.

Rezultatet tregojnë se 21 mësimdhënës apo 100% nga pjesëmarrësit e gjinisë mashkullore kanë pohuar se kanë mbështetje nga ana e drejtorit, gjithashtu rezultatet tregojnë se edhe 39 mësimdhënëse apo 100% nga pjesëmarrësit e këtij hulumtimi të gjinisë femërore kanë pohuar se kanë mbështetje nga ana e drejtorit.

Tabela 17. Krahasimi i variablave të strukturës së gjinisë dhe lavdërimit nga ana e drejtorit për punën e tyre.

		Gjinia					
		Mashkull		Femër		Totali	
		Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)	Numri (N)	Përqindja (%)
Lavdërimi nga ana e drejtorit për punën e tyre	Po	17	81.5%	32	83.5%	49	82.5%
	Pjesërisht	4	18.5%	7	16.5%	11	17.5%
	Jo	0	-	0	-	0	-
Totali		21	100.0%	39	100.0%	60	100.0%

Në tabelën nr.17 janë të paraqitur të dhënat të cilat janë përdorur për të krahasuar variablat të strukturës gjinore të mësimdhënësve dhe lavdërimit nga ana e drejtorit për punën e tyre.

Mësimdhënësit e gjinisë mashkullore kanë pohuar 17 prej tyre pjesëmarrës në këtë hulumtim se drejtori i tyre i lavdëron ata për punën e tyre dhe pjesërisht kanë pohuar 4 mësimdhënëse të gjinisë mashkullore.

Ndërsa mësimdhënëset e gjinisë femërore kanë pohuar 49 mësimdhënëse se ato i lavdëron drejtori për punën e tyre dhe 11 mësimdhënëse kanë pohuar se pjesërisht ato i lavdëron drejtori për punën e kryer.

